

Korniza për Menaxhimin Mjedisor dhe Social

Për Projektin

**Mbështetje për Zhvillimin Lokal përmes Përfshirjes së të Rinjve në
Kosovë**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Nëntor 2018, Prishtinë

Shkurtesat

OBK	Organizata Bazë në Komunitet
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore
KPV	Korniza e Partneritetit të Vendit
VM	Vlerësimi Mjedisor
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KMMS	Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
EAQ	Evropa dhe Azia Qendrore
BE	Bashkimi Evropian
KAG	Komisioni për Aprovim të Granteve
BPV	Bruto Produkti Vendor
MKA	Mekanizmi i Korrigjimit të Ankesave
QK	Qeveria e Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FJZHS	Fondi Japonez për Zhvillim Social
AMMK	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KPVK	Korniza e Partneritetit të Vendit (KPV) e Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizata Joqeveritare
NMP	Njësia e Menaxhimit të Projektit
ZM	Zonat e Mbrojtura të Kosovës
SHSP	Shëndeti dhe Siguria në Punë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

MM	Masat Mbrojtëse
MZHLPRK	Mbështetje për Zhvillimin Lokal përmes Përfshirjes së të Rinjve në Kosovë
YIEP	Përfshirja e të Rinjve dhe Ndërmarrësia

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	6
Prezantim i shkurtër i Kosovës	7
Zonat e mbrojtura (ZM) të Kosovës.....	8
Trashëgimia kulturore fizike	10
Shqetësimet kryesore mjedisore.....	10
Objektivat dhe komponentët e projektit.....	11
Objektivi zhvillimor i projektit	11
Komponentët e projektit.....	11
Komponenti 1: Iniciativat për zhvillimin e komunitetit të udhëhequra nga të rinjtë (1,719,000 \$).....	11
Komponenti 2: Trajnimi i akterëve rinorë (777,000 \$)	12
Komponenti 3: Menaxhimi dhe administrimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi, dhe shpërndarja e njohurive (280,000 \$).....	13
Linjat e mbështetjes financiare	13
Aktivitetet e papranueshme.....	13
Lista e përjashtimeve	14
Menaxhimi i projektit	14
Monitorimi dhe vlerësimi	15
Ekzaminimi mjedisor.....	15
Kategoria A	15
Kategoria B	16
Kategoria B+	16
Kategoria B-	16
Kategoria C	16
Masat institucionale dhe zbatuese	17
Politikat e BB-së që aplikohen për projektin	18
PO/PB 4.01 (Vlerësimi mjedisor)	18
PO/PB 4.09 (Menaxhimi i brejtësve) – nuk zbatohet.....	19
PO/PB 4.11 (Burimet fizike kulturore) – nuk zbatohet.....	19
PO/PB 4.10 (Popujt indigjenë).....	19
Përmbledhje e legjislacionit kombëtar dhe Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social	20
Ndikimet e mundshme mjedisore	22
Masat Zbutëse	23
Vlerësimi mjedisor.....	24
Rishikimi Mjedisor	24
Mekanizmi i Korrigjimit të Shqetësimeve.....	25
Monitorimi i pajtueshmërisë dhe raportimit të PMSM-së	26
Shpалosja dhe konsultimet	26
SHTOJCA.....	27
SHTOJCA 1 - PËRGJEGJËSITË DHE PJESËMARRËSIT KYÇ.....	27
SHTOJCA 2 - PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT MJEDISOR DHE SOCIAL PËR INFRASTRUKTURË (madje edhe për infrastrukturë të vogël).....	28
Emri i seksionit:.....	28
SHTOJCA 3 –FORMA E LISTËS KONTROLLUESE TË PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL.....	30
Hyrje.....	30
Ndikimet potenciale mjedisore.....	30
Aktivitetet e nën-projektit dhe ndikimet mjedisore.....	30
Lista kontrolluese e PMMS-së	30
Aplikimi i Listës kontrolluese PMS	31
Monitorimi dhe Raportimi	31
ANEKSI 4 - MODELI I PLANIT TË MENAXHIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR	43
Zbutjen.....	43

Monitorimi.....	43
Plani i Zbatimit dhe Vlerësimet e Kostove.....	43
Plani i zbutjes	44
Plani i monitorimit	44

Hyrje

Projekti ‘‘Mbështetje për Zhvillimin Lokal p rmes P rfshirjes s  t  Rinjve n  Kosov ’’ ka p r synim t  p rmir soj p rfshirjen socio-ekonomike t  m  s  paku 3,000 t  rinjve t  margjinalizuar (t  moshave 15-29 vje ), q  jan  pjes  e komuniteteve t  cenueshme n  Kosov , p rmes aktiviteteve t  angazhimit qytetar.

Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)  sht  p rgatitur nga Ministria e Administrimit t  Pushtetit Lokal, duke u bazuar n  Politikat e Masave Mbrojt se t  BB-s  p r k t  lloj projekti. N d r t  tjera, dokumenti KMMS sh rben si mjet p r t  ekzaminuar n n-projektet, dhe n  baz  t  rezultateve t  ekzaminimit, udh zon klient t dhe akter t tjer  n  lidhje me procedurat e kujdesit t  duhur mjedisor, duke p rfshir  VM-t  dhe menaxhimin e mjedisit n  t  gjitha fazat e ciklit t  projektit.

Zhvillimi dhe zbatimi i projektit bazohet n  dh nien e granteve stimuluese p r 10 komuna t  p rzgjedhura. Komunitetet e p rzgjedhura do p rfitojn  nga ndarja e granteve stimuluese, t  cilat do u mund sojn  atyre t  zgjerojn  programimin e tyre p r t  rinjt  dhe t'i p rmbushin m  mir  nevojat p r ta. Qeverit  lokale do sigurojn  q  n n-projektet q  kan  prioritet t  rinjt , do integrohen n  planet lokale t  veprimit dhe do leht sojn  zbatimin e tyre.

Grupet e t  rinjve do ken  t  drejt  t  paraqesin propozime p r n n-projektet t  cilat adresojn  nevojat socio-ekonomike t  t  rinjve. K to propozime do identifikohen me an  t  n j procesi gjith p rfshir s dhe pjes marr s, q  p rfshin diskutime n  fokus grupe me n ngrupe t  ndryshme t  t  rinjve (pakicat etnike, personat me aft si t  kufizuara, LGBT, grat , PZHBV-t  dhe refugjat t) p r t  siguruar q  nevojat e t  gjith  t  rinjve pasqyrohen si  duhet n  dizajnimin e n n-projektit. Propozimet p r n n-projekte mund t  p rfshijn  (i) sh rbimet ekonomike q  synojn  p rmir simin e pun simit t  rinjve dhe mund sit  p r gjenerimin e t  ardhurave (p.sh. trajnimet p r ngritjen e aft sive, p rmir simin e qasjes n  tregun e pun simit, trajnimet p r nd rmarr si, kurset e TIK-ut, etj.), (ii) p rmir simet n  infrastruktur n q  nd rlidhet me t  rinjt  (d.m.th. riparimin e qendrave rinore, parqeve, klasave, hap sirave miq sore p r t  rinjt  n  qendrat sh ndet sore dhe bibliotekave), (iii) aktivitetet kulturore dhe sportive p r t  rinjt , (iv) mb shtetjen psiko-sociale dhe k shillimin emocional, ose (v) mund sit  shtes  p r pun  vullnetare p r t  rinjt  me qellim t  adresimit t  nevojave t  komunitetit. Nismat specifike t  drejtuara nga t  rinjt  nuk mund t  p rcaktohen si prioritete pasi q  nxiten nga k rkesat dhe do t'u p rgjigjen nevojave t  pa-p rmbushura t  t  rinjve n  nevoj  n  nivel komuniteti. K to jan  disa nga aktivitetet e identifikuar nga p rfaq suesit dhe ekspert t e organeve t  siguris  p r parandalimin e ekstremizmit t  dhunsh m (PEDH), t  cilat mungojn  tek komunitetet e cenueshme. Duke investuar n  aft sit , njohurit  dhe aktivitetet e t  rinjve, projekti i propozuar do t  fuqizoj  t  rinjt  e pa-favorizuar q  t  b hen agjent  t  ndryshimit n  komunitetet e tyre dhe t  ulin ndjeshm rin  e tyre ndaj ndikimeve negative.

T  gjitha n n-projektet q  do t  financohen n  kuad r t  YIEP dhe do t'i n nshtrohen n j procesi t  shqyrtimit mjedisor duke p rfshir  procedurat e p rshkruara n  k t  dokument. K to procedura dhe k rkesa p rfshijn  legjislacionin mjedisor t  Kosov s dhe politikat e masave mbrojt se t  Bank s Bot rore. T  gjitha aktivitetet e Projektit duhet t  jen  n  p rputhje me rregulloret komb tare dhe politikat e BB-s , d.m.th si rregull, mbizot rojn  normat m  t  rrepta.

Projekti i p rgjithsh m u klasifikua si projekt i kategoris  B, q  p rcakton se vet m n n-projektet e kategoris  B mund t  mb shteten gjat  funksionimit. Pra,  sht  aktivizuar Politika e Bank s Bot rore OP / BP 4.01 Vler simi Mjedisor, dhe pasi q  n nprojektet dhe vendndodhjet nuk jan  t  njohura,  sht  zhvilluar n j proces i KMMS-s . T  gjitha n n-projektet do t  rishqyrtohen gjat  periudh s s  p rgatitjes, dhe projektet e kategoris  A dhe ato t  papranueshme do t  p rjashtohen.

Zbatimi dhe pajtueshm ria e p rgjithshme me politikat e KMMS-s  dhe BB-s   sht  p rgjegj si e NMP-s /MAPL-s  p r periudh n e zbatimit t  projektit, 2019-2022 dhe e akter ve tjer  t  p rfshir  p r  do aktivitet tjet r n  kuad r t  projektit, nd rsa p r zbatimin e dokumenteve t  Vler simit Mjedisor dhe masave t  mbrojtjes s  mjedisit dhe p r n n-projektet e infrastruktur s  sht  p rgjegj se Komuna n  p rputhje me monitorimin e drejtp rdrejte t  n n-projekteve nga NMP-ja/ MAPL-ja. Zbatimi i KMMS-s  monitorohet nga MAPL-ja, p rkat sisht nga NMP-ja, n  bashk punim t  ngusht  me Komunitetet.

Pun t e lehta civile t  kategoris  B - dhe aktivitetet e kategoris  C pritet t  kryhen sipas projektit, kurse n n-projektet e kategoris  A ose me rrezik t  lart , ose p r t  cilat k rkohe t  realizohet VNM sipas Ligjit t  Kosov s

për Mjedis, nuk do të finanohen. Në përgjithësi, procedurat mjedisore dhe sociale të aplikuar në ciklin e nën-projektit, dhe përgjegjësitë e palëve kyçe, përshkruhen më poshtë në mënyrë të detajuar .

Prezantim i shkurtër i Kosovës

Kosova është një vend pa dalje në det që gjendet në qendër të Evropës Juglindore. Ajo kufizohet me Shqipërinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë. Sipërfaqja e saj e përgjithshme është 10.887 km². Vendi ndodhet në një lartësi mbidetare prej 400-700 m, i rrethuar nga disa vargmale të larta, me lartësi mbidetare nga 2.000 deri 2.500m¹.

Popullsia prej 1.8 milion banoreve e Kosovës ka vazhduar me trendin rritës, prandaj ka pasur një rritje në zgjerimin e vendbanimeve dhe ndryshime në shfrytëzimin e tokës. Në vitin 2012, vendbanimet mbuluan 4.7% të territorit të Kosovës, krahasuar me 3.7% në vitin 2002. Tokat bujqësore janë zvogëluare nga 31.3% e territorit të Kosovës sa ishin në vitin 2002 në 27.8% në vitin 2012 (për shkak të zgjerimit të vendbanimeve). Tokat pyjore u rritën nga 42.1% e territorit të Kosovës në vitin 2002 në 44.7% në vitin 2012. Gjithashtu në vitin 2012, rreth 78% e popullsisë është furnizuar me ujë nga ujësjellësi publik (4% më shumë se në 2011), ndërsa rreth 56% e popullsisë kishte qasje në shërbimet e ujërave të zeza (5% më shumë se në vitin 2011).²

Kosova në territorin e saj përfshin pellgjet e sipërme të katër lumenjve që rrjedhin në tri dete të ndryshme: Adriatik, Egje dhe Deti i Zi. Lumi Ibër derdhet në lumin Danub, duke e bërë atë pjesë të një prej sistemeve kryesore të lumenjve të Evropës. Kosova shërben si ujëmbledhës për ujërat që rrjedhin në vendet fqinje, por për shkak të topografisë së saj të lartë, nuk merr ujë nga jashtë kufijve të saj. Ekziston vetëm një digë e madhe në Kosovë e ndërtuar për gjenerimin e hidro-energjisë, por vendet fqinje kanë ndërtuar diga në lumenjtë në rrjedhën e poshtme të Kosovës. Shumë pjesë të lumenjve janë prekur rëndë nga mihjet e zallit dhe zhavorrit dhe nga përpjekjet për të kontrolluar përmbytjet e lumenjve me pendë artificiale³.

Klima e Kosovës ndikohet nga afërsia e saj me Detin Adriatik dhe Egje, si dhe nga masa tokësore kontinentale evropiane në veri. Klima e përgjithshme është klimë kontinentale e modifikuar, me disa elementë të një klime nën-mesdhetare në jugun e thellë dhe një regjim alpin në malet më të larta. Dimrat janë të ftohtë me temperaturë mesatare në janar dhe shkurt prej 0 gradë celsius dhe me akumulim të theksuar të dëborës, sidomos në male. Verërat janë të nxehta, me ekstreme deri në 40 gradë. Reshjet mesatare vjetore në Kosovë janë 720 mm, por mund të arrijnë në më shumë se 1.000 mm në male. Thatësitë e verës nuk janë të rralla. Lartësitë e ndryshme mbidetare, ndikimet klimatike dhe tokat brenda Kosovës ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë të mikro-habitateve në të cilat janë përshtatur speciet bimore dhe shtazore⁴.

Kosova është e prirur ndaj mjaft rreziqeve natyrore - duke përfshirë përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, thatësitë, tërmetet dhe zjarret pyjore - që mund të sjellin dëme në ekonomi, në ekuilibrat fiskale dhe mirëqenien e popullatës së cënueshme. Shumë nga këto rreziqe që ndërliken me klimën pritet të zmadhohen me ndryshimet e ardhshme klimatike. Këto rreziqe klimatike si dhe fatkeqësitë mund të ndikojnë seriozisht në sektorët prodhues të ekonomisë, siç janë bujqësia, infrastruktura, energjia, burimet ujore, komunitetet dhe ekonomitë familjare. Fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike gjithashtu mund të pengojnë reformat dhe të shtojnë presion mbi pozicionin fiskal, të përkeqësojnë presionet ekzistuese të shpenzimeve, të pengojnë përdorimin e burimeve publike në plane afatgjata të zhvillimit dhe të kufizojnë aftësinë e një vendi për të ndërtuar rezerva për programet e zhvillimit dhe nevojat e ardhshme. Ato gjithashtu mund t'i devijojnë kapacitetet e pakta administrative të qeverisë drejt operacioneve emergjente⁵.

Ekonomia e Kosovës ka shënuar progres drejt kalimit në një sistem të bazuar në treg dhe në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, por është ende shumë e varur nga bashkësia ndërkombëtare dhe diaspora për ndihmë financiare dhe teknike. Remitenat nga diaspora - kryesisht nga Gjermania, Zvicra dhe vendet nordike - llogariten të përbëjnë rreth 17% të BPV-së dhe asistencë ndërkombëtare e donatorëve përbën rreth 10% të BPV-së. Përmes asistencës ndërkombëtare, Kosova ka qenë në gjendje të privatizojë shumicën e ndërmarrjeve shtetërore⁶.

¹ Ibid.

² <https://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo>

³ http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnact349.pdf

⁴ http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnact349.pdf

⁵ <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

⁶ <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

Prodhimi i mineraleve dhe metaleve - duke përfshirë linjtin, plumbin, zinkun, nikelin, kromin, aluminin, magnezin dhe një shumëllojshmëri të gjerë të materialeve ndërtimore - dikur shtylla kurrizore e industrisë, ka pësuar rënie për shkak të vjetërsimit të pajisjeve dhe investimeve të pamjaftueshme. Problemet janë përkeqësuar nga pretendimet pronësore konkurruese dhe të pazgjdhura për minierat më të mëdha të Kosovës. Furnizimi i kufizuar dhe jo i besueshëm me energji elektrike është një pengesë e madhe për zhvillimin ekonomik, por ka pasur disa arritje. Në vitin 2012, Kosova privatizoi rrjetin e saj të furnizimit dhe distribucionit. Në bashkëpunim me BB-në dhe Qeverinë e SHBA-ve, MZHE-ja po punon për të përmbyllur një tender komercial për ndërtimin e termocentralit Kosova C, një termocentral i ri me linjit që do të shfrytëzoj rezervat e mëdha të linjtit në Kosovë. MZHE-ja gjithashtu ka plane për rehabilitimin e termocentralit të vjetër Kosova B dhe zhvillimin e një miniere të ngjillit që do të mund t'i furnizonte të dyja termocentralet⁷.

Në qershor të vitit 2009, Kosova u anëtarësua në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe filloi të paguante pjesën e vet të borxhit të ish-Jugosllavisë. Për të ndihmuar integrimin e Kosovës në strukturat ekonomike rajonale, UNMIK-u nënshkroi (në emër të Kosovës) pranimin e saj në Zonën e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) në vitin 2006. Kosova u anëtarësua në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vitin 2012 dhe në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës në vitin 2013. Në 2016, Kosova realizoi negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në, të përqendruar në liberalizimin e tregtisë. Sipas MSA-së, Kosova - e cila merr afërsisht 58% të të ardhurave të qeverisë nga tarifat mbi importet - duhet të heqë tarifat për mallrat e BE-së gjatë shtatë viteve të ardhshme. Në vitin 2014, gati 60% e importeve të pranueshme doganore në Kosovë ishin mallra të BE-së. Në vitin 2015, Kosova negocioi një Marrëveshje Stand-By (MSB) prej 185 milionë dollarësh me FMN-në, pas përfundimit të MSB-së së saj të mëparshme në vitin 2014. FMN-ja kërkoi shtyrjen e MSB-së aktuale deri në gusht 2017 për të lehtësuar vazhdimësinë e politikave dhe për të mundësuar kohë të mjaftueshme për përparimin e reformave strukturore në vazhdim. Në gusht të vitit 2015, si pjesë e procesit të normalizimit me Serbinë, Kosova nënshkroi marrëveshje për telekomunikacionin dhe për distribucionin e energjisë, por brenda Kosovës vazhdojnë mosmarrëveshjet rreth zotëruesve të pasurive ekonomike, siç është konglomerati i minierave të Trepçës⁸.

Ndërkohë që ekonomia e Kosovës ka vazhduar të shënojë progres, ajo ka nevojë për reforma dhe investime të mëtejshme për të mundësuar nivelin e kërkuar të rritjes për të ulur papunësinë dhe për të rritur standardet e jetesës në një mënyrë kuptimplote⁹.

Zonat e mbrojtura (ZM) të Kosovës

Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura përfshin 116 zona natyrore (ose 10.9% të territorit të vendit¹⁰). Territorin më të madh të zonave të mbrojtura e zënë parqet nacionale "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"¹¹.

Në vitin 2012, kur Kosova e shpalli parkun e saj të dytë nacional Bjeshkët e Nemuna (62.488 hektarë), ajo gjithashtu e zgjeroi territorin e parkut të saj të parë nacional Sharri. Këto dy veprime e rritën përqindjen e përgjithshme të zonave të mbrojtura në Kosovë nga 4.36% (më 2003) në 10.9% të territorit kombëtar. Përveç këtyre dy parqeve kombëtare, Kosova ka edhe 97 hektarë të zonave të tjera të mbrojtura natyrore të kategorive të ndryshme¹². Shihni hartën më poshtë për paraqitjen vizuale të zonave të mbrojtura¹³.

⁷ Ibid.

⁸ <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

⁹ <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>


¹⁰ <http://www.landscapeonline.de/wp-content/uploads/DOI103097-LO201545.pdf>

¹¹ *Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura në Kosovë (shkarkimi në PDF në dispozicion)*. Gjetendet në:

https://www.researchgate.net/publication/259368759_Biodiversity_and_Protected_Areas_in_Kosovo [qasur më 26 shkurt 2018].

¹² <https://www.eea.europa.eu/soer-2015/countries/kosovo>

¹³ <http://www.landscapeonline.de/wp-content/uploads/DOI103097-LO201545.pdf>



Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (2015)

Trashëgimia kulturore fizike

Kosova ka qenë e banuar që nga kohërat parahistorike. Gjetjet më të reja arkeologjike datojnë nga periudha e hershme neolitike, pra mijëvjeçari i 6-të p.l.k., dhe përfshijnë figura të ndryshme antropomorfike dhe zoomorfike të pllëshmërisë, si dhe qeramika të ngjyrosura. Në antikitet, kishte qendra tejet të urbanizuara me kulturë të rafinuar në hapësirën e Kosovës së sotme¹⁴. Prandaj, nuk është e habitshme që Kosova është djep i trashëgimisë së rëndësishme kulturore dhe fetare, e jo vetëm i pasurive natyrore.

Trashëgimia kulturore e Kosovës përfshin monumente, vende, objekte si dhe atributet e tyre të paprekshme të krijuara nga të gjithë popujt që kanë jetuar në Kosovë gjatë shekujve.

Për sa u përket pasurive natyrore, ka një numër të liqeneve të vogla dhe të mesme në Kosovë duke përfshirë disa liqene alpine me origjinë glaciale që janë me interes shkencor dhe skenik.

Shqetësimet kryesore mjedisore

Kosova përballet me një numër rreziqesh mjedisore, si më poshtë:

- Ndotja e ajrit është një problem i rëndësishëm në zonat urbane të Kosovës dhe një problem i moderuar për vendin në tërësi. Cilësia e ajrit në mjedisin urban është e dobët sidomos në Prishtinë, në zonën e Obiliqit, në zonën e Drenasit dhe në Mitrovicë. Burimet kryesore të ndotjes përfshijnë (a) djegien e drurit dhe linjtit për qëllime të ngrohjes shtëpiake/ndërtim, dhe në një masë më të vogël aktivitetet e prodhimit të energjisë dhe të minierave; (b) tymi dhe emetimet nga komplekset e mëdha industriale; (c) deponitë e mbeturinave urbane dhe industriale të cilat kanë tendencë të kenë ndikime më specifike lokale; dhe (d) emetimet e automjeteve. Ndikimet kryesore të shëndetit nga ndotja e ajrit janë të lidhura me nivelet e larta të grimcave (PM), të njohura edhe si grimca të imta ose pluhur¹⁵.
- Cilësia e ujit. Të dhënat nga Instituti i Shëndetit Publik mbi cilësinë e ujit të pijshëm tregojnë se ndotja e ujit të pijshëm është përgjithësisht e lidhur me kontaminimin bakterial dhe jo kimik. Pjesa më e madhe e këtij kontaminimi bakterial (fekal) ndodh në sistemet e furnizimit me ujë të qyteteve të vogla dhe zonave rurale ku një pjesë e madhe e puseve dhe burimeve mendohet të jenë të ndotura, megjithëse nuk ekzistojnë shifra të sakta. Problem është edhe mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë.¹⁶
- Mbeturinat e rrezikshme dhe të papërpunuara komunale. Mbeturinat nga e kaluara dhe ato aktuale industriale kanë mbetur - për periudha të gjata kohore - në zonat e prodhimit, zonat e deponimit dhe pikat e përqendruara industriale. Përveç aktiviteteve të minierave dhe industrisë që prodhojnë rreth 1.3 milion ton të mbeturinave në vit (komerciale, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme), rreth 382,000 ton mbeturina të ngurta komunale gjenerohen çdo vit. Aktualisht, ekziston një mungesë afërsisht e plotë e menaxhimit të duhur të mbeturinave në Kosovë për të gjitha llojet e mbeturinave - shtëpiake, industriale, të kujdesit shëndetësor dhe mbeturinave të rrezikshme - si dhe për ndotjen e trashëgimisë nga kontaminimi historik. Praktika e tanishme e menaxhimit të mbeturinave, nëse mbetet e pandryshuar, do të çojë në nivele të larta të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe të ajrit (për shembull, përmes metanit ose gazit të deponive), por edhe dioksinave dhe grimcave të imta me rastin e djegies së mbeturinave.
- Burimet pyjore janë nën presion që nga viti 1990, ku shumica e lëndës së parë drusore e prerë ilegalisht përdoret për dru zjarri dhe ku është bërë prerje masive e drunjve për rindërtimin e shtëpive pas luftës. Përveç kësaj, mungesa e burimeve financiare për trajtimin e duhur të seri kulturës, sidomos rrallimi para-komercial në fazën e re të zhvillimit të pyjeve është e nevojshme për t'i kthyer pyjet në menaxhimin dhe rritjen e dëshiruar.¹⁷

¹⁴ <http://unesdoc.unesco.org/images/0013/001344/134426e.pdf>

¹⁵ <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

Objektivat dhe komponentët e projektit

Objektivi zhvillimor i projektit

Objektivi zhvillimor i projektit është që të përmirësojë përfshirjen socio-ekonomike të të paktën 3,000 të rinjve të marginalizuar (të moshës 15-29 vjeç) në komunitetet e cenushme të Kosovës përmes aktiviteteve të angazhimit qytetar.

Komponentët e projektit

Projekti i propozuar do të plotësojë operacionin e planifikuar për të rinjtë në Kosovë, “Përfshirja dhe Ndërmarrësia e të Rinjve” (YIEP), i cili përqendrohet në rritjen e mundësive socio-ekonomike për të rinjtë joaktivë përmes qasjes së përmirësuar në pjesëmarrjen qytetare, zhvillimin e aftësive dhe shërbimet e ndërmarrësisë së qëndrueshme (shih Kornizën e Partneritetit për Kosovën/KCPF FY17-21). YIEP (10.4 milionë dollarë) ofron zgjidhje për të mbështetur përfshirjen socio-ekonomike të të rinjve në një ekonomi ku ka krijim të kufizuar të vendeve të punës, veçanërisht për të rinjtë e marginalizuar. JSDF-ja e propozuar do të plotësojë përpjekjet për përfshirje të YIEP-së duke pilotuar zgjidhjen për adresimin e nevojave socio-ekonomike të të rinjve në nivel komuniteti. Të rinjtë e aktivizuar përmes grantit të propozuar të JSDF-së do të drejtohen në mundësitë shtesë socio-ekonomike dhe sipërmarrëse të ofruara nga YEIP-ja për të rritur shanset e tyre për integrim ekonomik. YIEP do të aplikohet në 10 komuna, do të synojë popullatën e njëjtë të të rinjve të marginalizuar dhe do të zbatohet në koordinim (d.m.th. Sistemi i M&V me treguesit e harmonizuar). Projekti i propozuar nuk përfshihet në përgatitjen e YEIP-së pasi që paraqet një iniciativë të re që do të pilotohet nga Qeveria e Kosovës (QeK) përpara se të prezantohet në ndërhyrjet e mëvonshme në bazë të rezultateve të projektit. QeK ka shprehur interes në riorganizimin e mbështetjes për programet e të rinjve përmes sistemeve ekzistuese qeveritare. Në veçanti, MAPL-ja do të vlerësojë rezultatet e pilotimit për të integruar mbështetjen për iniciativat e të rinjve si pjesë e sistemit të ardhshëm të ndarjes së granteve të bazuar në performancë.

Komponenti 1: Iniciativat për zhvillimin e komunitetit të udhëhequra nga të rinjtë (1,719,000 \$)

Ky komponent do të financojë iniciativat socio-ekonomike të udhëhequra nga të rinjtë në nivel të komunitetit, të cilat mbështesin gjithëpërfshirjen dhe jetesën. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) do të ndajë grante stimuluese për komunat e zgjedhura për iniciativa rinore në kuadër të ciklit vjetor të granteve. Ky komponent pritet të financojë 150 iniciativa të drejtuara nga të rinjtë duke përfshirë të paktën 3,000 të rinj të marginalizuar në identifikimin, priorizimin dhe projektimin e nën-projekteve. Të rinjtë pjesëmarrës do të përfitojnë nga mundësitë e punës vullnetare për të ndikuar pozitivisht në komunitetet e tyre dhe tek të rinjtë e tjerë të marginalizuar, njëkohësisht duke fituar përvojë të vlefshme pune dhe shkathtësi, gjëra këto që i bëjnë të rinjtë më tërheqës për punëdhënësit potencialë. Nga iniciativat e komunitetit të drejtuara nga të rinjtë do të përfitojnë rreth 5,000 të rinj si rrjedhojë e qasjes së përmirësuar në shërbimet për të rinjtë dhe në infrastrukturën e komunitetit.

Partneriteti me komunat. MAPL-ja do të përzgjedhë 10 komuna përmes vlerësimit të bazuar në vlerësimin paraprak të nevojave dhe hartëzimit, ku përfshihet: (i) kërkesa e madhe dhe ofrimi i kufizuar i shërbimeve të infrastrukturës së të rinjve, (ii) përqendrimi i lartë i të rinjve joaktivë, (iii) prania e kufizuar e donatorëve ndërkombëtarë, dhe (iv) prania relative e lartë e komuniteteve të pakicave etnike (serbët, ashkallitë, boshnjakët, romët, turqit, egjiptasit, goranët dhe malazezët). Iniciativat e drejtuara nga të rinjtë do të realizohen në komunitetet e cenushme të komunave të përzgjedhura, duke përfshirë ato me nivele më të larta të jo-aktivitetit të të rinjve, me shkallë më të lartë të varfërisë dhe me qasje të kufizuara në shërbimet për të rinjtë.

Komunat e përzgjedhura do t'i nënshtrohen vlerësimit të kapaciteteve për t'u siguruar që ato kanë kapacitetin për menaxhimin efikas të grantit stimulues që u ndahet atyre. Ky vlerësim do të bazohet në sistemin e MAPL-së për ndarjen e granteve stimuluese në bazë të performancës, në kuadër të të cilit vlerësohet performanca

komunale karshi një sërë treguesish financiarë dhe menaxherialë¹⁸. Në pajtueshmëri me zbatimin aktual nga ana e MAPL-së të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale, Ministria do t'u ndajë grante stimuluese komunave të përzgjedhura, por duke mbajtur përgjegjësitë e menaxhimit financiar. Për të marrë pjesë, komunat duhet të plotësojnë 15 për qind të grantit stimulues që u ndahet me financim homolog. Gjithashtu, komunat do të emërojnë zyrtar për të lehtësuar zbatimin dhe mbikëqyrjen e nën-projekteve. Kontributet komunale do të sigurojnë pronësinë lokale dhe qëndrueshmërinë e programeve rinore duke i përfshirë aktivitetet në planet zhvillimore komunale, si dhe do krijojnë bashkëpunim dhe besim më të madh në mes të rinjve dhe akterëve komunalë.

Kriteret e përzgjedhjes. Propozimet për nën-projekte do të shqyrtohen karshi kriterëve të përzgjedhjes që do të vendosen, në kuadër të të cilave rëndësi më e madhe u jepet nën-projekteve që: (i) mundësojnë pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve në identifikimin dhe projektimin e nën-projektit, (ii) sjellin përfitime për numër më të madh të të rinjve, (iii) përfshijnë mundësi për punë vullnetare të të rinjve gjatë fazës zbatuese të nën-projektit, (iv) janë në pajtueshmëri me planet komunale për të rinjtë, dhe (v) sjellin të rinj me përkatësi të ndryshme etnike në mënyrë që të fuqizojnë bashkëpunimin ndëretnik dhe të përmbyllin ndarjen ekzistuese shoqërore¹⁹. Për të siguruar që nën-projektet të kenë mbështetjen e komunitetit, propozimet duhet të miratohen prej të paktën një subjekti të komunitetit (këshillat e lagjes, shoqatat fetare, qendrat rinore, etj.). Vlera e nën-grantit nuk do të tejkalojë 30,000 \$. Nën-grantet komunale do t'u jepen OJQ-ve dhe OBK-ve rinore në disa këste në bazë të një sistemi rigoroz që përfshin: (i) thirrjen për propozime, (ii) trajnimin mbi hartimin e propozimeve për OBK-të, (iii) shqyrtimin dhe vlerësimin teknik të propozimeve, (iv) shqyrtimin e sigurisë për të siguruar pajtueshmërinë e plotë me kërkesat kombëtare dhe të Bankës Botërore, (v) vlerësimin e projekteve nga Komiteti për Miratimin e Granteve, (vi) marrëveshjen e nën-grantit, duke përfshirë zbatimin e rregullave fiduciare të Bankës Botërore; dhe (vii) disbursimin e nën-gratit dhe monitorimin e shpenzimeve të pranueshme. Për grupet rinore të formuara rishtazi, fondet mund të menaxhohen nga OJQ-ja/OJQ-të partnere asistuese sipas dizajnit të nën-projektit të zhvilluar nga të rinjtë dhe të miratuar nga projekti.

Komponenti 2: Trajnimi i akterëve rinorë (777,000 \$)

Ky komponent do të financojë: (i) mobilizimin e komunitetit dhe aktivitetet në terren, (ii) trajnimin e aftësive të buta dhe trajnimin për përgatitjen/menaxhimin e projektit për të rinjtë në komunitetet e synuara, (iii) mbështetjen teknike për OJQ-të dhe OBK-të rinore të cilët dorëzojnë një aplikacion të para-zgjedhur nga komunat për financim, dhe (iv) përcjelljen e mbështetjes dhe mbikëqyrjes gjatë zbatimit të nën-projektit. MAPL-ja do të zgjedhë në mënyrë konkurruese një OJQ me përvojë për të zbatuar aktivitetet në kuadër të këtij komponenti. Nga ky komponent pritet të përfitojnë drejtpërsëdrejti 3,000 të rinj nëpërmjet trajnimit mbi aftësitë e buta dhe mbi menaxhimin e projektit, ndërsa në mënyrë të tërthortë do të përfitojnë rreth 5,000 të rinj të marginalizuar falë fuqizimit të specifikimeve teknike të nën-projekteve të dizajnuara për të përmirësuar qasjen e të rinjve të marginalizuar në shërbimet socio-ekonomike.

Mobilizimi i komunitetit: OJQ-ja partnere asistuese do të zhvillojnë fushata të informimit në komunitet për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve të marginalizuar, duke përfshirë OJQ-të dhe OBK-të rinore, rreth aktiviteteve të projektit dhe për t'i inkurajuar ata të aplikojnë. Aktivitetet e përfshirjes do të përfshijnë fushatat derë-më-derë, takimet me akterët kryesorë të komunitetit (këshillat e lagjeve, grupet e të rinjve, qendrat rinore, OJQ-të lokale dhe përfaqësuesit e bashkësisë fetare), vendosjen e fletushkave dhe posterave në vende strategjike në zonat e synuara (qendrat rinore, kafenetë, zyrat e autoriteteve lokale ose vende tjera të frekuentuara nga të rinjtë). OJQ-ja partnere asistuese gjithashtu do të përgatisin profile të shkurtra të komunitetit që përshkruajnë nevojat e të rinjve si dhe shërbimet ekzistuese të infrastrukturës miqësore për të rinjtë, në mënyrë që të ofrojnë informata për hartimin e nën-projekteve dhe të mbështesin grupet e të rinjve në përcaktimin e prioritetëve të objektivave të komunitetit.

OJQ-të partnere asistuese do të ofrojnë trajnime mbi aftësitë e buta për 3,000 të rinj të marginalizuar, me theks në aftësitë e udhëheqjes, kreativitet, ndërmjetësim të konfliktit, komunikime dhe punë ekipore. Këto trajnime do të rrisin mundësinë e punësimit të të rinjve duke u fokusuar në aftësitë e buta të vlerësuara nga punëdhënësi potencial dhe që janë jetike për të menaxhuar në mënyrë efektive një biznes, si dhe do të lehtësojnë bashkëpunimin në punën e përbashkët të komunitetit. Trajnimi mbi aftësitë e buta do të jetë pika hyrëse për të gjithë të rinjtë e interesuar për elaborimin e propozimeve të nën-projekteve në kuadër të projektit. Pas

¹⁸ Ndryshimet në komunat e para-zgjedhura që burojnë nga ky vlerësim duhet të mos kundërshtohen nga Banka Botërore.

¹⁹ Një e katërta e të rinjve të anketuar në anketën Pulsi Publik 2018 deklaruan që pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta ishte mënyra më e mirë për përmirësimin e raporteve mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. UNDP Kosovë (2018), Analiza e Pulsit Publik.

përfundimit të trajnimit mbi aftësitë e buta, të rinjtë përfitues mund të formojnë grupe ose të përdorin OJQ-të ekzistuese për të përgatitur propozime për nën-projekte. Trajnimet do të fokusohen në mobilizimin e komunitetit, përgatitjen e nën-projekteve (duke përfshirë projektimin, targetimin e përfituesve, buxhetimin) dhe zbatimin (prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin pjesëmarrës dhe vlerësimin). Trajnimi do të bazohet në plan programin e fjalës së fundit në lidhje me projektimin dhe menaxhimin e projekteve të komunitetit, duke përfshirë qasjet pjesëmarrëse si dhe identifikimin dhe dizajnimin e projekteve që marrin parasysh klimën.²⁰ Përveç kësaj, nën-projektet e përzgjedhura për financim do të marrin mbështetje të vazhdueshme për të siguruar zbatimin efektiv të tyre.

Komponenti 3: Menaxhimi dhe administrimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi, dhe shpërndarja e njohurive (280,000 \$)

MAPL-ja do të themelojë një Njësi për Menaxhimin e Projekteve (NjMP) e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të projektit. NjMP-ja do të përbëhet nga një ekip i personelit i dërguar nga MAPL-ja, si dhe nga një ekip i vogël i konsulentëve për të mbështetur funksionet kyçe të raportimit, ato fiduciare dhe të mbrojtjes. Specifikisht, personeli i dërguar nga ministria do të përfshijë drejtorin e projektit, dy koordinatorët e komponentëve (një për secilin komponent), zyrtarin për kapacitete dhe performancë si dhe zyrtarin për M&V, ndërsa ekipi i konsulentëve të financuar nga projekti do të përfshijë koordinatorin e projektit, specialistin për menaxhim financiar, një specialist të prokurimit dhe një konsulent për mbrojtjen e mjedisit. Përveç kësaj, MAPL-ja do të sigurojë hapësirë pune, transport, si dhe do të mbulojë shpenzimet logjistike dhe administrative.

Linjat e mbështetjes financiare

Fondet do të transferohen nga Banka Botërore tek Thesari i Ministrisë së Financave dhe tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të gjitha fondet lidhur me projektin do të menaxhohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Të gjitha shpenzimet e projektit duke përfshirë personelin, kostot e aktiviteteve të projektit, kontraktorët, nën-zbatuesit dhe administrimi i projekteve do të menaxhohen nga MAPL-ja në përputhje me procedurat e menaxhimit financiar dhe të prokurimit të Bankës Botërore.

Përgjegjësitë për prokurimin e punëve për çdo nën-projekt do të përcaktohen gjatë zbatimit të projektit nga rasti në rast varësisht nga kapaciteti i aplikantëve (shfrytëzuesit final të fondeve). Është paraparë që OJQ-të me përvojë të bëjnë vetë prokurimin për aktivitetet e tyre, ndërsa OJQ-ve /iniciativave të rinjve ose individëve që nuk kanë përvojë do t'u ofrohet ndihmë shtesë për zbatimin e prokurimit (nga OJQ-të asistuese ose personeli i MAPL-së). Për më tepër, për OJQ-të/iniciativat/individët e papërvojë, prokurimi do të bëhet nga MAPL-ja, ku do të caktohet një kufi deri në të cilin ata mund ta bëjnë vetë prokurimin, ndërsa përtej këtij kufiri prokurimi do të bëhet në emër të tyre. Punimet do të kontraktohen nga nën-projektet e përfituesve të projektit, ndërsa në mungesë të kapacitetit MAPL-ja do ta bëjë prokurimin për to.

Aktivitetet e papranueshme

Në kuadër të projektit nuk do të financohen aktivitetet në zona të mbrojtura dhe në objekte dhe/ose hapësira të trashëgimisë kulturore, as ato që prekin Politikën e Mbrojtjes të BB-së përveç asaj 4.01 Vlerësimi Mjedisor.

Aktivitetet e pranueshme nuk duhet të bien ndesh me Politikën Operative (PO) 4.12 të Bankës Botërore mbi zhvendosjen e pavullnetshme. Gjithashtu, ky projekt nuk mund të financojë nën-projekte që përfshijnë:

- Aktivitete që kufizojnë ose ndalojnë qasjen individuale ose të komunitetit në tokë ose burime të disponueshme;
- Aktivitete që shkaktojnë blerjen e tokës ose zhvendosjen e individëve ose komuniteteve;
- Aktivitete në zona të mbrojtura dhe habitate natyrore të ndjeshme ose kritike, si dhe nën-projektet që përfshijnë prerjen e drunjve;

²⁰ Me anë të rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive praktike rreth ndryshimeve klimatike të rinjtë e synuar, projekti inkurajon përzgjedhjen dhe projektimin e iniciativave të drejtuara nga të rinjtë që marrin parasysh aspektet klimatike. Shembuj mund të jenë renovimi i infrastrukturës duke marrë parasysh klimën dhe iniciativat për ndryshimin e sjelljeve (p.sh., zvogëlimi i mbeturinave të ngurta, eficientia e energjisë në banesa, transporti pa emetime).

- Aktivitete që sjellin ndryshime në përdorimin e pesticideve;
- Aktivitete që prekin trashëgiminë kulturore.

Nën-projektet që mund të rezultojnë në prodhimin e sasive të mëdha të mbeturinave të rrezikshme (mbeturinat e azbestit, CFL-të, mbetjet e ngjyrës së plumbit, rezervuarët e ndotur me vaj të ngrohjes, etj.) ose lloje të posaçme të mbeturinave të rrezikshme (p.sh. rrufepritësit radioaktivë) nuk do të jenë të pranueshëm për financim.

Gjersa rreziqet që lidhen me nën-projekte të ndryshme mund të jenë të nivelit të ulët, mesatar ose të lartë, të gjitha rreziqet pritet të jenë në kategorinë B ose C të VM-së.

Lista e përjashtimeve

Një numër aktivitete janë të papranueshme për financim në kuadër të projektit. Këto përfshijnë blerjen e tokës, projektet e kategorisë A dhe të rrezikut të lartë, si dhe aktivitetet nga lista e përgjithshme e përjashtimeve të BB-së, si në vijim:

1. Tregtimi i kafshëve të egra dhe produkteve të kafshëve të egra të ndaluara sipas Konventës CITES,
2. Lirimi i organizmave të ndryshuar gjenetikisht në mjedisin natyror,
3. Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e pesticideve dhe herbicideve të ndaluara,
4. Peshkimi me rrjet në mjedisin detar,
5. Prodhimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve radioaktive,
6. Deponimi, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme,
7. Prodhimi i pajisjeve dhe aparateve që përmbajnë CFC, halon dhe substanca të tjera të rregulluara sipas Protokollit të Montrealit,
8. Prodhimi i pajisjeve elektrike që përmbajnë bifenile të poliklorinuara (PCB) në vlerë mbi 0,005% të peshës,
9. Prodhimi i produkteve që përmbajnë asbest,
10. Reaktorët bërthamorë dhe pjesët e tyre,
11. Duhani, i papërpunuar ose i përpunuar,
12. Makineritë për përpunim të duhanit, dhe
13. Prodhimi i armëve të zjarrit.

Menaxhimi i projektit

MAPL-ja do të themelojë një Njësi për Menaxhimin e Projekteve (NjMP) e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të projektit. NjMP-ja do të përbëhet nga një ekip i personelit të dërguar nga MAPL-ja, si dhe nga një ekip i vogël i konsulentëve për të mbështetur funksionet kyçe të raportimit, ato fiduciare dhe masave mbrojtëse. Specifikisht, personeli i dërguar nga ministria do të përfshijë drejtorin e projektit, dy koordinatorët e komponentëve (një për secilin komponent), zyrtarin për kapacitete dhe performancë si dhe zyrtarin për M&V, ndërsa ekipi i konsulentëve të financuar nga projekti do të përfshijë koordinatorin e projektit, specialistin për menaxhim financiar, një specialist të prokurimit dhe një konsulent për mbrojtjen e mjedisit. Përveç kësaj, MAPL-ja do të sigurojë hapësirën e punës, transportin, si dhe do të mbulojë shpenzimet logjistike dhe administrative.

Përgjegjësitë kryesore të NjMP-së do të përfshijnë: koordinimin e projektit, prokurimin, menaxhimin financiar, masat mbrojtëse, menaxhimin e komunikimit dhe njohurive, si dhe monitorimin dhe vlerësimin. Në kuadër të komponentit 1, NjMP-ja do të jetë përgjegjëse për: (i) vlerësimin e kapaciteteve komunale për menaxhimin fiduciar dhe të programit për zbatimin e projektit në bazë të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale, (ii) menaxhimin e alokimit dhe shpenzimeve të fondeve të projektit, (iii) mbikëqyrjen e pajtueshmërisë komunale me kriteret e projektit, (iv) sigurimin e mos-kundërshtimit për përzgjedhjen e nën-projekteve, (v) mbikëqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse, monitorimit dhe raportimit për të siguruar që ato janë në përputhje me kërkesat e masave mbrojtëse/fiduciare. Për komunat që plotësojnë kriteret e përcaktuara në përskrimin e projektit, por demonstronë kapacitete relativisht të ulëta, NjMP-ja mund të zgjedhë të iniciojë një ose disa veprime korigjuese, si: (i) shpërndarjen e fondeve, por duke marrë përsipër procesin e prokurimit; (ii) Zyrtari i Performancës nga MAPL-ja të punojë drejtpërdrejt me zyrtarët komunalë përgjegjës për hapjen e ofertave, vlerësimin e propozimeve dhe menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe/ose (iii) kërkimin e raportimeve shtesë/më të shpeshta nga zyrtarët komunalë. Për komponentin 2, MAPL-ja do të prokurojë OJQ-të partnere asistuese me përvojë për të mbajtur trajnime mbi aftësitë e buta, përgatitjen e propozimeve për nën-projekte dhe trajnimin e menaxhimit, si dhe do të ofrojë mbështetje teknike për OJQ-të/OBK-të rinore gjatë gjithë ciklit të nën-projektit.

MAPL-ja do të bashkëpunojë ngushtë me komunat e përzgjedhura gjatë zbatimit të projekteve. Për të qenë të

pranueshme, komunat do të zotojnë burime për të mbështetur aktivitetet e projektit. Në veçanti, përgjegjësitë e komunave do të përfshijnë: (i) kryesimin e Komiteteve për Miratimin e Granteve dhe pjesëmarrjen në përzgjedhjen e nën-projekteve, (ii) sigurimin e 15 përqind të fondeve për të mbështetur iniciativat e drejtuara nga të rinjtë, (iii) mbështetjen e aktiviteteve për informimin e komunitetit, përkrah OJQ-ve partnere asistuese, për t'ua prezantuar projektin të rinjve të mundshëm përfitues, (iii) operacionet dhe mirëmbajtja për aktivitetet që lidhen me infrastrukturën ose hapësirat komunale, dhe (iv) mbështetjen teknike për grupet e të rinjve duke ofruar inxhinierët komunalë për nën-projektet të cilave u nevojiten specifikimet teknike.

Monitorimi dhe vlerësimi

MAPL-ja do të përcjellë progresin e të gjitha nismave të drejtuara nga të rinjtë duke përdorur një Sistem Informativ të Menaxhimit (SIM) në internet. Palët relevante të interesit do të jenë në gjendje të shohin dhe të plotësojnë platformën me të dhëna nga terreni në kohë reale. SIM-i do të koordinohet me sistemin e M&V-së në kuadër të YIEP-së, duke përfshirë treguesit e harmonizuar dhe të dhënat e përbashkëta të përfituesve. Pas përfundimit të aktiviteteve, siç është trajnimi i palëve të interesuara, Ministria do të përgatisë një raport të shkurtër përmblyës që përmbledh rezultatet dhe mësimet e nxjerra. Ky komponent gjithashtu do të financojë një anketë në fillim dhe një në fund të projektit, përmes të cilave do të vlerësohen ndikimet e projektit tek të rinjtë e synuar.

Grupet e masave që do të ndërmerren për të siguruar pajtueshmërinë e nën-projekteve të paracaktuara me Politikën e Masave Mbrojtëse të BB dhe legjislacionit nacional për mjedisin, do të përgatiten si një draft shabllon i Listës Kontrolluese të PMSM-së, si pjesë përbërëse e KMMS-së (shih Shtojcën 3). Shablloni i Listës Kontrolluese të PMSM-së (që përmban masat zbutëse dhe planin e monitorimit) do të përshtatet për secilin nën-projekt individual të kategorisë B (pune te voga). Përveç kësaj, ajo do të përcaktojë përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe raportimit, si dhe afatin kohor. PMSM-ja do të hartohet për të gjitha nën-projektet dhe aktivitetet e tjera me ndikime të mundshme negative.

Ekzaminimi mjedisor

Ekzaminimi mjedisor është hapi i parë në procesin e kujdesit ndaj mjedisit në kuadër të shqyrtimit të aplikacionit/konceptit të nën-projektit. Qëllimi i tij është të përcaktojë rrezikun mjedisor të ndërlidhur me nën-projektin e propozuar, të refuzojë aplikacionet të cilat janë të papranueshme për shkak të natyrës së aktiviteteve të propozuara dhe/ose vendndodhjes, të klasifikojë aplikacionet e pranueshme sipas kategorive mjedisore dhe të identifikojë llojin e VM-së që do të nevojitet. Rezultatet e shqyrtimit mjedisor do të pasqyrohen në raportin e VM-së dhe të ekzaminimit mjedisor.

Në procesin e ekzaminimit, në varësi të llojit, vendndodhjes, ndjeshmërisë dhe shkallës së projektit si dhe natyrës dhe madhësisë së ndikimeve të mundshme mjedisore, nën-projekti do të klasifikohet në një nga katër kategoritë në vijim:

Kategoria A

Aktivitetet e kategorisë A nuk do të financohen përmes skemës së nën-huazimit.

Një nën-projekt i propozuar klasifikohet në këtë kategori nëse ka gjasa që të ketë ndikime të pafavorshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin natyror, të cilat janë shumë të rëndësishme, të ndryshme dhe/ose afatgjata, madhësia e të cilave është e vështirë të përcaktohet në fazën identifikuese të nën-projektit. Këto ndikime mund të ndikojnë gjithashtu në një zonë më të gjerë që tejkalon vendet e nën-projektit. Masat për zbutjen e rreziqeve të tilla mjedisore mund të jenë komplekse dhe të kushtueshme.

Prandaj nevojitet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e ardhshme mjedisore që lidhen me projektin e propozuar, për të identifikuar mundësitë e mundshme të përmirësimit të mjedisit dhe për të rekomanduar çdo masë të nevojshme për të parandaluar, minimizuar dhe zbutur ndikimet negative.

Nën-huamarrësi është përgjegjës për përgatitjen e një raporti, zakonisht të VNM-së. Krahas këtij raporti, nën-huamarrësi gjithashtu duhet të ofrojë studimin e fizibilitetit tekniko-ekonomik të nën-projektit. Kostot e masave zbutëse do të përfshihen në VNM dhe në studimin e fizibilitetit.

Për projektet e kategorisë A, studimi i ndikimit mjedisor parashihet me ligjet e Republikës së Kosovës, veçanërisht Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (nr. 03/L-214). Ky akt ligjor identifikon projektet për të cilët, sipas rregulloreve të Kosovës, VNM-ja është e detyrueshme dhe për cilët janë opsionale (kërkesë e Autoritetit Kompetent). Aktivitetet e identifikuar në Shtojcën I dhe Shtojcën II (opsionale) të Ligjit për VNM-në nuk do të mbështeteshin nga projekti²¹.

Kategoria B

Një projekt i propozuar klasifikohet si i kategorisë B atëherë kur, edhe nëse ka ndikime të mundshme negative mjedisore në popullatën njerëzore ose në zonat me rëndësi mjedisore, ato janë më pak të pafavorshme se ato të projekteve të kategorisë A. Këto ndikime janë specifike për vende të caktuara; shumë pak prej tyre, nëse ka ndonjë, janë të pakthyeshme; dhe në shumicën e rasteve masat zbutëse mund të dizajnohen më lehtë se sa për projektet e kategorisë A. Fushëveprimi i VM-së për një projekt të kategorisë B mund të ndryshojë ndërmjet nën-projekteve. Ashtu si VM-ja e kategorisë A, ai shqyrton ndikimet e mundshme negative dhe pozitive mjedisore të projektit dhe rekomandon masat e nevojshme për të parandaluar, minimizuar, zbutur ose kompensuar ndikimet negative dhe për të përmirësuar performancën mjedisore.

Kategoria B+

Për projektet e kategorisë B +, huamarrësi është përgjegjës për përgatitjen e një VNM-je të plotë (në varësi të opinionit të dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose zyra qendrore) ose një para-VMN-je (VNM e thjeshtë) që përfshin, sipas nevojës, elementë të instrumenteve të tjera të cilat thjesht mund të kërkojnë përkufizimin e masave zbutëse të përcaktuara mirë dhe miratimin e praktikave të pranuar të veprimit. Nën-huamarrësi duhet të ofrojë paralelisht studimin e fizibilitetit teknik të nën-projektit. Kostot e masave zbutëse do të përfshiheshin në VNM ose PMSM, si dhe në studimin e fizibilitetit.

Kategoria B-

Për projektet e kategorisë B nevojitet një VM për të vlerësuar çdo ndikim të mundshëm në mjedis që ndërlidhen me projektin e propozuar, për të identifikuar mundësitë potenciale për përmirësimin e mjedisit dhe për të rekomanduar masat e nevojshme për parandalimin, minimizimin dhe zbutjen e ndikimeve negative. Qëllimi dhe formati i VM-së ndryshon në varësi të projektit, por zakonisht janë më të ngushtë se fushëveprimi i VNM-së, zakonisht në formë të PMSM-së (PMSM e plotë ose Listë kontrolluese e PMSM-së).

Fushëveprimi i PMSM-së është përcaktuar në Shtojcën 4. Për projektet që përfshijnë përmirësime të thjeshta, rindërtim ose përshtatje të ndërtesave, do të përdoret lista kontrolluese e PMSM-së (shih Shtojcën 3).

Kategoria B- përfshin nën-projektet që gjithashtu: (a) përfshijnë kredi për kapital qarkullues, të cilat përfshijnë blerjen dhe/ose përdorimin e materialeve të rrezikshme (p.sh. pesticide) ose (b) përmirësime të procesit të kredive që përfshijnë blerjen e pajisjeve/makinerive që paraqesin një rrezik potencial të rëndësishëm ndaj shëndetit ose sigurisë.

Një projekt i propozuar klasifikohet si i kategorisë B- nëse ndikimet e ardhshme mjedisore janë më pak të dëmshme se ato të projekteve të kategorisë A dhe B+, duke marrë parasysh natyrën, madhësinë dhe vendndodhjen e tyre, si dhe karakteristikat e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Kategoria C

Një projekt i propozuar klasifikohet si i kategorisë C nëse ka të ngjarë të ketë ndikime minimale ose jo të dëmshme mjedisore dhe prandaj nuk kërkon as VNM dhe as analizë mjedisore. Përveç ekzaminimit, asnjë veprim i mëtejshëm i VM-së nuk kërkohet për një projekt të kategorisë C.

²¹ <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

Kategoria mjedisore	Dokumentacioni mjedisor që duhet përfshirë në pakon e aplikimit për nën-hua
Kategoria C	Arsyetimi për kategorinë (Miratimet/lejet zyrtare të zbatueshme)
Kategoria B-	Miratimet/lejet zyrtare (të zbatueshme) A) PMSM (shtojca 4); ose B) Lista kontrolluese e PMSM-së (shtojca 3)
Kategoria B+	Opsioni 1) Miratimet/lejet zyrtare Deklarata “Nuk nevojitet VNM-ja” (nëse është e zbatueshme) Raporti i para-VNM-së (nëse është e zbatueshme) PMSM-ja (shtojca 4) Opsioni 2) Vetëm deklarata PMSM qëndron

Masat institucionale dhe zbatuese

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e Kosovës do të jetë agjencia përgjegjëse për zbatimin e projektit. Mandati i MAPL-së është të mbështesë autonominë lokale dhe të forcojë kapacitetet e komunave për të ofruar shërbime me kosto efektive për qytetarët e tyre. MAPL-ja nuk ka zbatuar më parë ndonjë operacion të financuar nga Banka Botërore; ajo ka ekspertizë teknike, sisteme dhe përvojë me menaxhim të projekteve për të zbatuar në mënyrë efektive projektin e propozuar, megjithatë, i mungon përvoja lidhur me masat mbrojtëse. Me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të kapaciteteve të saj, MAPL-ja do të mbështetet gjithashtu nga një ekip specialistësh, duke përfshirë koordinatorin e projektit, specialistin e menaxhimit financiar, specialistin e prokurimit dhe konsulentin për masat e mbrojtjes mjedisore (MM).

Konsulenti për MM mjedisore duhet të jetë person me përvojë në menaxhimin e mjedisit në projektet e infrastrukturës dhe mundësisht në masat mbrojtëse në BB ose në projekte të tjera ndërkombëtare FI. Konsulenti do të ndjekë një trajnim gjysmë-ditor mbi KMMS si dhe Politikat dhe Procedurat Mbrojtëse të BB-së nga specialisti mjedisor i BB-së.

Funksionet kyçe të MAPL-së do të përfshijnë: (i) ndarjen e granteve stimuluese për komunat e dedikuara për iniciativat e drejtuara nga të rinjtë, (ii) kontraktimin e OJQ-ve partnere asistuese, (iii) sigurimin e moskundërshtimit për nën-projektet për të siguruar pajtueshmërinë me udhëzimet e projektit, fiduciare dhe ato mbrojtëse, si dhe përgjegjësinë e përgjithshme për pajtueshmërinë e Projektit me politikat MM të BB-së, dhe (iv)

M&V dhe shpërndarjen e njohurive. MAPL-ja do të bashkëpunojë ngushtë me komunat dhe OJQ-të partnere asistuese për të siguruar zbatimin efektiv të aktiviteteve të projektit. MAPL-ja do të udhëheqë komunat e përzgjedhura në menaxhimin dhe përgatitjen e thirrjeve për propozime. Komunat do të mbështesin përpjekjet e MAPL-së duke siguruar 15 për qind të vlerës së granteve stimuluese të ndara për iniciativat e drejtuara nga të rinjtë. Përveç kësaj, komunat do të jenë përgjegjëse për (i) kryesimin e mbledhjeve të Komitetit për Miratimin e Grantit për të vlerësuar dhe përzgjedhur iniciativat e drejtuara nga të rinjtë, (ii) integrimin e planeve të veprimit rinor në planet zhvillimore komunale për të siguruar qëndrueshmërinë e programeve të të rinjve, (iii) mbështetjen e specifikimeve teknike të nën-projekteve kur është e nevojshme përmes inxhinierëve komunalë, dhe (iv) mbështetjen e përgjithshme në zbatimin e nën-projektit në nivel komunal. Komunave do t'u kërkohet të sigurojnë hapësirë fizike për konsultime dhe takime me palët e interesuara të të rinjve.

Ekzistojnë disa OJQ, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, me përvojë të gjatë në zbatimin e projekteve të financuara nga qeveria ose donatorët që mbështesin aktivitetet e të rinjve në Kosovë, duke përfshirë edhe pjesën veriore të Kosovës me shumicë serbe. Kështu, është realiste që projekti mund të sigurojë shërbimet e një OJQ-je me përvojë për të realizuar ngritjen e kapaciteteve të parapara në Komponentin 2 të Projektit.

Politikat e BB-së që aplikohen për projektin

Politikat e mbrojtjes mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore janë të domosdoshme për qëllimin e dyfishtë të BB, për të luftuar varfërinë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët. Objektivi i këtyre politikave është parandalimi dhe zbutja e dëmeve të panevojshme të shkaktuara gjatë procesit të zhvillimit për popullsinë, jetesën dhe habitatin e tyre. Këto politika sigurojnë udhëzime për mbrojtjen e mjedisit dhe pajtueshmërinë për BB-në dhe huamarrësit/klientët në identifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe projekteve.

Sipas politikave të Bankës Botërore, projekti është përcaktuar si projekt i kategorisë mjedisore B, që do të thotë se nuk ka ndikim të rëndësishëm në mjedis nga zbatimi i aktiviteteve të projektit. Nën-projektet që do të financohen në kuadër të projektit mund të përfshijnë: rehabilitim/adaptim në masë të vogël të objekteve sportive, gjelbërimin dhe projektimin e parkut, zëvendësimin e pajisjeve (dyert, dritaret, çatitë), pajisjet e argëtimit në natyrë, idetë që gjenerojnë të ardhura për biznese të vogla fillestare, programe trajnimi që gjenerojnë të ardhura për të rinjtë që nuk janë të përfshirë (rrobaqepësia, gjuhët, të shkruarit e CV-së, rrjetet e punës online për të rinjtë, etj.). Si rezultat, punimet civile në shkallë të vogël dhe potencialisht aktivitete të tjera janë të mundshme, kështu që vlen politika e BB-së PO/PB 4.01 Vlerësimi Mjedisor.

Dhjetë politikat dhe procedurat e mbrojtjes mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore përcaktojnë kërkesat që duhet të përmbushë projekti gjatë ciklit jetësor të tij, si në vijim:

PO/PB 4.01 (Vlerësimi mjedisor)

Një projekt i propozuar klasifikohet si i kategorisë B dhe kërkon zbatimin e politikës për shkak të skemës së granteve që do të mbështesë punimet e lehta civile në infrastrukturën e komunitetit që ka të bëjë me rininë (p.sh. rehabilitimi dhe riparimi i qendrave rinore, parqeve, klasave, hapësirave miqësore për të rinjtë në ndërtesat publike). Këto punë civile mund të shkaktojnë ndikime të përkohshme dhe të lokalizuara mjedisore tipike për punime të tilla si pluhuri dhe zhurma, gjenerimi i mbeturinave, rreziqet e sigurisë së trafikut, rreziqet e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHSHP) dhe të tjera. Për të menaxhuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore gjatë zbatimit, MAPL-ja si institucion zbatues ka hartuar Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS), e cila do të shkojë në konsultim publik dhe do të finalizohet para vlerësimit. Një KMMS e përgjithshme është përgatitur për Projektin, duke ndjekur politikat dhe procedurat e BB-së për konsultimin dhe zbulimin, përpara vlerësimit të projektit. KMMS-ja përcakton procedurat dhe udhëzon shqyrtimin dhe vlerësimin e nën-projekteve, duke përfshirë përgatitjen e Planeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMSM) dhe/ose listave kontrolluese të PMSM-së gjatë projektit që do të vihen në konsultim publik para kontraktimit të punimeve. Për të siguruar kapacitetet dhe burimet për zbatimin e tyre, VM-të (PMSM-ja ose lista kontrolluese e PMSM-së) do të jenë pjesë përbërëse e dokumentacionit të ofertimit dhe kontraktimit. KMMS-ja eliminon projektet e kategorisë A, ato të papranueshme dhe atome rrezik të lartë, si dhe punimet në zonat e mbrojtura dhe ato që ndikojnë në trashëgiminë kulturore.

PO/PB 4.04 (Habitatet natyrore) – nuk zbatohet.

Kjo politikë kufizon rreptësisht rrethanat nën të cilat një projekt i mbështetur nga Banka mund të ndikojë ose ndryshojë habitatet natyrore (tokat dhe ujërat ku janë ende të pranishme shumica e llojeve bimore dhe shtazore) si dhe parqet, zonat natyrore ose zonat e tjera të shpallura si të mbrojtura. Projektet duhet të shmangin, minimizojnë, restaurojnë ose kompensojnë çdo aktivitet që shkakton degradimin e habitatit natyror. Projektet që do të shkaktonin konvertim ose degradim të rëndësishëm të habitatit natyror kritik (zona të mbrojtura me ligj ose ato me vlerë të lartë ruajtjeje) nuk janë të pranueshme për financim.

Meqë kjo politike nuk preket, aktivitetet që zhvillohen në zonat e mbrojtura dhe të ndjeshme nuk do të financohen.

Ndërhyrjet në shkallë të vogël do të bëhen për shkak të aktiviteteve të nën-projektit, ndërhyrjet në sallat sportive ose vendet për aktivitete rinore mund të zhvillohen në ndërtesat ekzistuese publike ose në hapësirat urbane të gjelbëruara (p.sh. parqet), por duke mos përfshirë zonat e mbrojtura. Punimet e planifikuara do të jenë të shkallës së vogël dhe do të përdorin vetëm hapsirat ekzistuese pa veprimtari të dëmshme.

PO/PB 4.36 (Pyjet) – nuk zbatohet.

Kjo politikë lehtëson projektet që përfshijnë menaxhimin e pyjeve duke përfshirë prerjet, mbjelljen, ripyllëzimin dhe të ngjashme. Aktivitetet në kuadër të këtij projekti nuk kanë të bëjnë me aktivitete që mund të ndikojnë në pyje. Si rregull, nuk do të lejohet asnjë skenar që mund të ndikojë tek pyjet, por nëse heqja e pemëve individuale do të jetë e pashmangshme, do të kërkohet leje nga autoriteti kompetent (Agjencia e Pyjeve të Kosovës).

PO/PB 4.09 (Menaxhimi i brejtësve) – nuk zbatohet.

Nuk zbatohet politika për menaxhimin e brejtësve. Nuk janë planifikuar aktivitete që përfshijnë ose kanë nevojë për kontroll të brejtësve ose ndryshime në kontrollin e brejtësve dhe të tilla as që do të mbështeteshin.

PO/PB 4.11 (Burimet fizike kulturore) – nuk zbatohet.

Nuk ka asnjë aktivitet të kësaj natyre që të ndodhë për shkak të zbatimit të projektit. Meqenëse politika nuk zbatohet, KMMS-ja nuk lejon aktivitete që mund të ndikojnë në ndërtesat e mbrojtura, vendet arkeologjike, objektet fetare dhe burimet e ngjashme kulturore.

Meqenëse gjetjet e rastësishme janë të vështira që të ndodhin, por janë të mundura, do të përfshihet një klauzolë adekuate në dokumentacionin e vlerësimit mjedisor që parasheh procedurat e menaxhimit (listat kontrolluese të PMSM-së dhe PMSM-të për vendet specifike). Procedurat në rastin e gjetjeve të rastësishme do të ndjekin procedurat kombëtare dhe vendimet/opinionet e organit kompetent kombëtar (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit).

PO/PB 4.10 (Popujt indigjenë)

Nuk vlen, meqë nuk ka popuj indigjenë në zonën e projektit.

PO/PB 4.12 (Zhvendosja e pavullnetshme)

Meqenëse aktivitetet e parashikuara të projektit/nën-projekteve kanë natyrë tjetër për të prekur zhvendosjen e pavullnetshme. Projekti nuk do të financojë asnjë ndërtim të ri, por do të mund të financonte rehabilitimin e objekteve publike për t'i bërë ato më të përshtatshme për të rinjtë ose pajisjet për aktivitetet rinore. Të gjitha aktivitetet e rehabilitimit do të realizohen në tokën publike. Duke pasur parasysh natyrën publike të infrastrukturës/objekteve rinore, projekti nuk parasheh transaksione vullnetare të tokës. Nën-projektet që mund të nxisin PO 4.12 të Bankës Botërore do të përjashtohen me anë të një procesi të shqyrtimit të përcaktuar në KMMS. I vetmi rrezik i identifikuar shoqëror lidhet me synimin dhe shtrirjen, gjegjësisht projekti të mos përfshijë segmentin më të cenueshëm të rinisë në komunat e zgjedhura. Prandaj, projekti parasheh që si mbështetje për NjMP-në dhe komunat e përzgjedhura të angazhohet një OJQ/konsultim i specializuar për të ndihmuar përcaktimin e caktit, informimin dhe mobilizimin e të rinjve më të cenueshëm.

PO/PB 4.37 (Siguria e digave) – nuk zbatohet.

Projekti/nën-projektet nuk përfshijnë aktivitete që ndërlidhen me diga.

PO/PB 7.50 (Projektet në rrugët ujore ndërkombëtare) - nuk zbatohet.

Projekti nuk mbështet aktivitetet që mund të kenë ndikim në trupat ujorë.

PO/PB 7.60 (Projektet në zona kontestuese) - nuk zbatohet.

Vendndodhja e aktiviteteve të projektit/nën-projekteve përfshin Kosovën Veriore, e cila nuk njeh Qeverinë Shtetërore të Kosovës dhe ku mund të ketë qasje të kufizuar për NjMP-në, MAPL-në si dhe ekipin e BB-së. Megjithatë, në bazë të disa marrëveshjeve dhe pajtimeve të nënshkruara më 2012 dhe 2013, kjo politikë nuk do të zbatohet. Megjithatë, rreziqet që lidhen me problemin e qasjes së kufizuar në veri të Kosovës duhet të njihen.

Përmbledhje e legjislacionit kombëtar dhe Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Ky dokument shërben si një kornizë për menaxhimin social dhe mjedisor të aktiviteteve në kuadër të projektit “Mbështetje për Zhvillimin Lokal përmes Përfshirjes së të Rinjve në Kosovë”, të financuar nga JSDF-ja. Në të njëjtën kohë, legjislacioni kombëtar dhe vendor duhet të respektohen plotësisht. Në rast të dallimeve në mes të politikave të BB-së dhe rregullave kombëtare dhe lokale të Kosovës, si rregull mbizotëron ajo më e rrepta.

Në bazë të legjislacionit të Kosovës, dy institucione kryesore hartojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin zbatimin e legjislaturës dhe rregulloreve mjedisore në Kosovë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Për shkak të punimeve civile të parapara në kuadër të Komponentit 1, ky projekt mund t’u nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës si në vijim:

- *Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;*
- *Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;*
- *Ligji nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit;*
- *Ligji nr. 2010/03-L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;*
- *Ligji nr. 2004/2015 për Ndërtim;*
- *Ligji për Mbeturinat (2012);*
- *Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma;*
- *Ligji nr. 04/L-147 për Ujerrat e Kosovës;*
- *Udhëzimi Administrativ MMPH/01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.*

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2002/8 është një akt ombrellë i kornizës ligjore dhe rregullatorë mjedisore të Kosovës. Qëllimi themelor i këtij ligji është krijimi i një kornize bazë ligjore që do të promovojë një mjedis gjithnjë e më të shëndetshëm për popullin e Kosovës përmes futjes graduale të Standardeve Mjedisore të Bashkimit Evropian²². Ligji trajton parandalimin dhe reduktimin e ndotjes, monitorimin e mjedisit dhe thekson, ndër të tjera, parimet e përdorimit racional të burimeve natyrore. Ndotja e mjedisit është subjekt i ndëshkimit sipas këtij ligji.

Ky Ligj rregullon, ndër të tjera, kërkesat dhe procedurat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). **Asnjë nga aktivitetet e parashikuara në projekt nuk përbëjnë potencial të tillë për ndikime negative mjedisore dhe as**

²² http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=109&Itemid=28&lang=en

nuk janë të listuara në Shtojcat I dhe II të Ligjit për të cilat VNM-ja do të ishte e detyrueshme ose opsionale.

Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që gjatë procesit të vendimmarrjes nga MMPH-ja për lëshimin e pëlqimit mjedisor, të ofrohen të gjitha informatat relevante në lidhje me mjedisin.

Të gjitha punimet tjera, rehabilitimet, rindërtimet dhe ndërtimet e vogla nuk kërkojnë VNM sipas legjislacionit kombëtar. Prandaj, për llojin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij projekti nuk kërkohet VNM ose ndonjë lloj tjetër i studimit mjedisor sipas legjislacionit nacional. (Lista e projekteve për të cilat nevojitet VNM-ja është në dispozicion në linkun e mëposhtme: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>).

Bazuar në kornizën ligjore në lidhje me Udhëzimin Administrativ MMPH/01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, Shtojca/Lista e aktiviteteve për të cilat duhet të merret leja mjedisore komunale, aktivitetet në kuadër të projektit “Mbështetje për Zhvillimin Lokal përmes Përfshirjes së të Rinjve në Kosovë” nuk bie në fushëveprimin e UA-së/MMPH/01/2017 të përmendur më sipër.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (2010/03-L-233) rregullon krijimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Drejtoritë për menaxhimin e parqeve kombëtare, parqeve natyrore dhe monumenteve natyrore me rëndësi të veçantë përcaktohen nga MMPH-ja, ndërsa kategoritë e tjera të zonave të mbrojtura drejtohen nga autoritetet e themeluara nga komuna.

Asnjë aktivitet i financuar nga ky projekt nuk mund të kryhet në zonat e mbrojtura të cilat janë të listuara në faqen e mëposhtme: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-233-eng.pdf>

Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (04/L-175) rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen e inspektimit, koordinimin e inspektimit mbikëqyrës, të drejtat, detyrat, kompetencat e inspektorëve, të drejtat, detyrimet dhe subjektet e mbikëqyrjes, procedurën për kryerjen e inspektimit dhe çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e inspektimit. Fushëveprimi i këtij Ligji merret me detyrat dhe kompetencat e inspektorëve nën mbikëqyrjen e fushave mjedisore, ujit, natyrës, planifikimit urban dhe ndërtimit brenda organeve të nivelit lokal dhe qendror duke përfshirë Inspektoratin Komunal për Ndërtim dhe Inspektoratin Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit. Sipas këtij ligji, Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Natyrës kryen mbikëqyrjen dhe kontrollin e inspektimit përmes inspektimit në natyrë duke zbatuar akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me mbrojtjen e natyrës. Inspektorati për mbrojtjen e natyrës gjithashtu kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mbrojtjen e natyrës, duke harmonizuar veprimtarinë e tij me kërkesat e Bashkimit Evropian për rrjetin "NATURE - 2000".

Ligji për Ndërtimin nr. 2004/2015 përcakton kërkesat kryesore për projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e materialeve ndërtimore, mbikëqyrjen profesionale, si dhe procedurat për lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe inspektimin e ndërtimit. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë kushtet e projektimit dhe ndërtimit në lidhje me sigurinë publike dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë dhe ato janë gjithashtu të zbatueshme për objekte të tjera ndërtimore, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me udhëzim administrativ²³.

Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës (2003) ka si qëllim kryesor parandalimin e lëndimeve në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe mbrojtjen e mjedisit të punës²⁴. Rregullon kushtet e punës në vendin e punës, të drejtat e punëtorëve dhe obligimet e punëtorëve, në përgjithësi. Nuk i përcakton këto çështje, përveç situatat e përgjithshme emergjente siç janë zjarri në vendin e punës, rreziqet elektrike, e kështu me radhë. Nuk mbulon ndonjë çështje specifike në lidhje me vendosjen e infrastrukturës. **Ky Ligj do të zbatohet plotësisht në aplikimin e nën-projekteve.**

Ligji për mbeturina (2012), Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani pesë-vjeçar për menaxhimin e mbeturinave (2013-2017) me veprime të bazuara në Strategji nga baza e legjislaturës së Menaxhimit të mbeturinave të ngurta (MMN). Sipas kësaj legjislature, Kosova ka themeluar një sistem rajonal të

²³ http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2004regs/RE2004_37_ALE2004_15.pdf

²⁴ http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=83&Itemid=28&lang=en

grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave. Kohëve të fundit, ajo ka nisur ndryshimet në sistemin e faturimit dhe grumbullimit, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e performancës financiare të sektorit²⁵.

MMPH-ja lëshon leje për menaxhimin e mbeturinave, leje për eksport, import dhe transit të mbeturinave dhe menaxhon mbeturinat e rrezikshme. Sa i përket licencave për menaxhimin e deponisë së mbeturinave, një ose më shumë komuna, sipas marrëveshjes, mund të përcaktojnë dhe përdorin lokacionin në territorin e tyre për ndërtimin e impianteve dhe pajisjeve të menaxhimit të mbeturinave. Nëse komunat nuk mund të arrijnë marrëveshje për vendosjen e një vendi të përbashkët për menaxhimin e mbeturinave, vendimi do të merret nga MMPH-ja në bazë të përmbushjes së kushteve, sipas këtij Ligji.

Ministri i MMPH-së mund të ndërmarrë masa shtesë për menaxhimin e llojeve të caktuara të mbeturinave, nëse mbeturinat dhe operacionet me mbeturina rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njerëzve dhe ekzistojnë kërkesa shtesë për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Kosovës është e detyruar.

Qeverisja lokale (komunat) është përgjegjëse për hartimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave, përcaktimin e lokacionit për nevojat e menaxhimit të mbeturinave komunale etj., sipas planit hapësinor dhe përcaktimin e tarifave për mbledhjen dhe asgjësimin e mbeturinave komunale. Sipas Ligjit, ata janë gjithashtu përgjegjës për përzgjedhjen e personave të licencuar (përmes zbatimit të procedurave të prokurimit) për grumbullimin, mbledhjen, ruajtjen dhe transportimin e mbeturinave të ngurta, mbeturinave komunale, voluminoze, nga ndërtimi dhe demolimi i ndërtesave si dhe ndërtesave komerciale brenda territorit të tyre. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) menaxhon deponitë sanitare të mbeturinave komunale.

Mbaturinat e rrezikshme menaxhohen sipas dispozitave të Ligjit mbi Mbeturina, pra MMPH-ja ka mandatin për të menaxhuar mbeturinat e rrezikshme, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse. Masat që duhet të ndërmerren për mbeturinat e rrezikshme janë përpunuar nga një Strategji Kombëtare 5 vjeçare për Menaxhimin e Mbeturinave.

Qëllimi i Ligjit Nr. 02/L-102 për mbrojtje nga zhurma është shmangja, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis. Ky ligj do të ofrojë bazë për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma²⁶.

Kosova ka rregulla të detajuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore: Kushtetuta, së bashku me Ligjin për trashëgiminë kulturore, Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura (duke përfshirë Ligjin për qendrën historike të Prizrenit dhe Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe), Ligjin për fshatin Zym i Hasit, Ligjin për lirinë fetare, Ligjin për shpronësimin, Ligjin për ndërtimin, Ligjin për Institucionet e Kulturës, dhe Ligjin për Vetëqeverisjen lokale; dhe ligjet tjera siç janë Ligji për Planifikimin hapësinor dhe Ligji për arkivat, aktet nën-ligjore siç janë ai për Këshillin zbatues dhe monitorues (KZM), i themeluar në përputhje me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura dhe aktet tjera administrative që sigurojnë mbrojtjen e veçantë të trashëgimisë kulturore dhe religjioze të kishës ortodokse serbe në Kosovë, si dhe dispozitat e bashkëpunimit evropian, dhe standardet e trashëgimisë kulturore ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, duke përfshirë ato që promovojnë diversitetin dhe dialogun kulturor dhe fetar²⁷. Përveç kësaj, Kosova ka një Strategji kombëtare për trashëgiminë kulturore (2017-2027)²⁸, qëllimi i parë i kësaj është avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në këtë fushë. Asnjë nga monumentet e renditura në listën kombëtare të trashëgimisë kulturore të mbrojtur nuk mund të përfshihet ose të ndikohet nga projekti. Në rastin e gjetjeve të rastësishme, projekti do të mbështetet në rregulloren kombëtare dhe do të ndjekë procedurat e përcaktuara në legjislacion.

Ndikimet e mundshme mjedisore

Në konsultime dhe në bazë të analizave hulumtuese në nivel institucional lidhur me ndikimin e projektit në mjedis

²⁵ <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

²⁶ http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=268&Itemid=28&lang=en

²⁷ http://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf

²⁸ http://mkrs-ks.org/repository/docs/eng_strategy_for_heritage.pdf

dhe duke iu referuar ndikimit shumë-dimENSIONAL në bazat e lartpërmendura ligjore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) arriti në konkluzion se mundësia e këtij projekti të ketë ndikim negativ ose të ndikojë në mjedisin është e ulët. Megjithatë, nëse nuk zbuten, ndikimet e kundërta, kryesisht të zakonshme për punët e lehta civile, mund të ndodhin. Përveç kësaj, lista e nënprojekteve të mundshme nuk është plotësisht e përcaktuar dhe janë të mundshme llojet e tjera të ndikimeve.

Ndikimet mjedisore të nën-projektit do të jenë tipike për punët e ndërtimitarisë në shkallë të vogël:

- Emetimet e pluhurit nga transporti që bart punonjësit dhe materialet;
- Pluhuri nga punimet tokësore, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve, heqja e mureve, llaçeve, izolimit dhe elementeve të tjera ndërtimore;
- SSHP rreziqet nga puna në lartësi, makineritë e rënda dhe vozitja, rreziqet nga aksidentet e ngatërrimit dhe rënies, neglizhimi i pajisjeve dhe veshjeve të sigurisë, procedurave ose shenjave paralajmëruese;
- Emetimet e zhurmës nga transporti dhe makineritë e rënda;
- Gjenerimi i mbeturinave - sasi e vogël e mbeturinave të ndërtimit do të gjenerohen kryesisht gjatë rehabilitimit të sallës së sporteve ose çdo punimi të vogël riparimi/ndërtimi (nëse ka) Mund të jetë rasti i disa sasive të vogla të mbeturinave të çimentos ose materialeve të tjera ndërtimore, qeramikës ose të tjera, por në çdo rast do t'u përmbahen Politikave të BB-së dhe ligjeve kombëtare në lidhje me trajtimin e deponimit të mbeturinave gjatë punimeve ndërtimore në shkallë të vogël.
- Ndikimi në tokë do të jetë shumë i kufizuar, megjithatë, disa derdhje dhe rrjedhje të karburantit, vajrave, bojës etj., janë të mundshme;
- Ndikimi në ujë - nuk është parashikuar asnjë ndikim në ujë, një shkallë e vogël është e mundur nga derdhjet e kufizuara të lëngjeve të rrezikshme;
- Ndikimi në natyrë nuk është parashikuar pasi që nuk do të bëhen punime në zonat e mbrojtura dhe punimet janë punime të kufizuara ndërtimore. Në rastin e punimeve në hapësira të hapura, p.sh. rehabilitimi i parqeve, do të duhet miratimi i autoriteteve kompetente për largimin e gjelbërimit dhe pemëve. Vetëm speciet bimore vendase do të përdoren në procesin e ri-gjelbërimit.

Masat Zbutëse

Efektet potenciale të pafavorshme që priten nga aktivitetet e projektit do të minimizohen duke zbatuar në mënyrë strikte legjisllacionin mjedisor kombëtar dhe lokal, procedurat dhe udhëzimet e KMMS-së si dhe masat dhe monitorimet e përcaktuara nga VM-ja. Lista kontrolluese e PMSM-së do të përgatitet nga aplikuesi për punët e lehta ndërtimore tipike, ndërsa PMSM-ja do të përcaktojë masat, do të shpërndajë përgjegjësitë, do të parashikojë buxhetin dhe do të përgatisë planin e monitorimit për të gjitha aktivitetet e tjera me potencial për të ndikuar negativisht në mjedis ose në shëndetin e njeriut, nëse ka ndonjë.

Ndikimet e identifikuar në kapitullin e mëparshëm janë të lokalizuara në një zonë të vogël, me ashpërsi të reduktuar, lehtësisht të zbutura me masat tipike për zvogëlimin e ndikimeve në punimet ndërtimore:

- Emetimet e pluhurit do të kufizohen duke përdorur tubin për hedhurina, përmes pastrimit të rregullt të zonës punuese, rrugëve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishtes dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës). Ngarkesa e transportuar e pluhurit do të mbulohet si dhe rezervat.
- Punëtorët do të veshin rroba mbrojtëse (kapela të forta, dorashka, etj.) dhe pajisje gjatë gjithë kohës.
- Zjarri i hapur do të jetë rreptësisht i ndaluar dhe po ashtu çdo lloj shqetësimi i kafshëve (gjuetia ilegale, kapja për tregti dhe të tjera), grumbullimi i bimëve, ushqimit pyjor, drurit dhe produkteve të tjera pyjore.
- Të gjitha lejet e kërkuara ligjërisht janë fituar për riparim, lloje të tjera të punëve ndërtimore dhe aktiviteteve të tjera.
- Të gjitha punët do të kryhen në një mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar, të dizajnuara për të minimizuar ndikimet ndaj banorëve fqinjë dhe mjedisit.
- Rugët e ndërtimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë.
- Vendpunishtja duhet të zërë vetëm sipërfaqet e nevojshme për kryerjen e punimeve.
- Gjatë ndërtimit, punëtorët duhet të kufizohen në zonat e ndërtimit dhe qasja në zonën e hapur përreth duhet të rregullohet në mënyrë të rreptë.
- Puna gjatë natës do të shmanget nëse është e mundur, sidomos në afërsi të vendbanimeve. Në rast se do të punohet gjatë natës duhet të merren lejet përkatëse.
- Terreni në vendin e punës duhet të kthehet në gjendjen e tij të mëparshme, nëse kjo nuk është e mundur,

- atëherë do të rehabilitohet në mënyrë adekuate.
- Grumbullimi, ndarja, transporti dhe përpunimi i mëtejshëm i mbeturinave do të realizohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të mbeturinave.

Lista e plotë e masave për punët e lehta ndërtimore është përcaktuar në listën kontrolluese të PMSM-së.

Vlerësimi mjedisor

Vlerësimi Mjedisor (VM) është një proces që synon njohjen e aspekteve të një aktiviteti të caktuar që mund të prodhojë rreziqe për mjedisin dhe shëndetin njerëzor, duke parashikuar, vlerësuar dhe zbutur ndikimet e tij të mundshme duke u siguruar që ato të minimizohen nëse eliminimi nuk është i realizueshëm. Qëllimi i VM-së është përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes duke njohur ndikimet/pasojat mjedisore në fillim të procesit të përgatitjes së nënprojektit, në mënyrë që ato të mund të përfshihen në hartimin e nënprojektit si dhe të parandalohen ose zbuten në kohë në fazat e zbatimit dhe operimit.

Fushëveprimi i VM-së varet nga kategoria mjedisore e bashkangjitur në secilin nën-projekt, nga fushëveprimi i aktiviteteve të nën-projektit si dhe nga tiparet e lokacionit të nën-projektit, edhe pse qëllimi i çdo lloji vlerësimi është të identifikojë mënyrat e përmirësimit të aktiviteteve të propozuara duke minimizuar, lehtësuar ose kompensuar ndikimet e tyre të pafavorshme në aspektin mjedisor. VM-ja, për qëllime të këtij projekti dhe të tjerave të mbështetura nga BB-ja, përfshijnë rreziqet e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (SHSP) si dhe rreziqet që lidhen me ruajtjen e trashëgimisë kulturore fizike (gjetjet e rastësishme në këtë rast). Rezultatet e VM-së janë paraqitur në raportin e vlerësimit mjedisor, të pasqyruar në rreziqet e identifikuara mjedisore (që lidhen me llojet specifike të aktiviteteve të nën-projektit) dhe të shoqëruara me masa adekuate. Masat paraqesin metodat, teknikat, procedurat dhe mënyrat e tjera të përmirësimit të nënprojekteve në aspektin mjedisor duke minimizuar, lehtësuar ose kompensuar ndikimet negative. Një VM gjithashtu përshkruan hapat që janë marrë për konsultime publike.

VM-të e parashikuara për aktivitetet në kuadër të këtij projekti janë Lista Kontrolluese e PMSM-së dhe PMSM-ja. Hartimi i modelit të listës kontrolluese të PMSM-së për punët e lehta ndërtimore që pritet të jenë veprimtaria më e zakonshme që lidhen me infrastrukturën përgatitet si një pjesë integrale e KMMS-së dhe gjendet në Shtojcën 3. Modeli i listës kontrolluese të PMSM-së (përmban masat zbutëse dhe planin e monitorimit) do të përshtatet për secilin nën-projekt individual B të punëve ndërtimore të parashikuar në Listën Kontrolluese. Përveç kësaj, ajo do të përcaktojë përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe raportimit dhe afatin kohor. PMSM-ja do të hartohet për të gjitha nënprojektet dhe aktivitetet e tjera që nuk janë parashikuar nga Lista Kontrolluese e PMSM-së, por mund të prodhojë ndikime të mundshme negative për mjedisin ose shëndetin e njeriut.

Rishikimi Mjedisor

Për të gjitha nën-projektet në kuadër të skemës së granteve, si dhe të gjitha aktivitetet që përfshijnë investime fizike ose mund të kenë ndikime negative mjedisore, do të realizohet procesi i rishikimit mjedisor të paraqitur më poshtë:

HAPI 1: Aplikuesi (përfituesi përfundimtar) përgatit dhe dorëzon një dizajn fillestar të nënprojektit në kuadër të thirrjes për propozim së bashku me Pyetësin e Vlerësimit të Rrezikut Mjedisor (në dispozicion në Shtojcën 2). Komiteti i Miratimit të Granteve e shqyrton aplikacionin dhe harton listën paraprake të Aplikuesve të suksesshëm. NJMP-ja (Konsulenti Mjedisor) e shqyrton nën-projektin në përputhje me KMMS-në (dhe në bazë të dizajnit, Pyetësin të Vlerësimit të Rrezikut Mjedisor dhe informacioneve të tjera) shqyrton nënprojektet që janë të kategorisë A, rrezik i lartë, rreth listave të përjashtimit, të papërshtatshëm ose që shkaktojnë politika të BB-së përveç OP/BP 4.01 dhe formon listën përfundimtare të Aplikuesve të suksesshëm që tani është dërguar për vlerësim. Konsulenti mjedisor përgatit Raportet e Shqyrtimit dhe informon Aplikuesin për kërkesat pasuese dhe VM-në e kërkuar për procesimin e nën-kredisë (një PMSM specifike për vendpunishten, ose një listë kontrolluese PMSM, modele në dispozicion në KMMS; arsyetimin pse VM-ja nuk është e nevojshme për nën-projektet e kategorisë C së paraqitur në Raportin e Shqyrtimit). Rezultatet e shqyrtimit i komunikohen BB-së. Në këtë kohë, është përgjegjësi e aplikuesit të iniciojë diskutime me NJMP-në dhe/ose me ndonjë organ tjetër kompetent për të përmbushur ndonjë kërkesë lokale dhe kombëtare mjedisore dhe të tjera (si për shembull, një opinion

mbi lejen mjedisore ose VNM-në (nëse ka nevojë), leje ndërtimore dhe/ose leje/miratime të tjera zyrtare).

HAPI 2: Aplikuesi përgatit VM-në (PMSM ose Listën kontrolluese të PMSM-së) për nën-projektin e kategorisë B dhe ia dorëzon NJMP-së për shqyrtim dhe miratim. NJMP-ja (Konsulenti Mjedisor) jep komente. Aplikuesi gjithashtu plotëson kërkesat e rregullimit kombëtar dhe lokal, nëse është e aplikueshme.

HAPI 3: Nëse kërkohet, Aplikuesi rishikon PMSM-në/listën kontrolluese të PMSM-së në përputhje me komentet/kërkesat e NJMP-së (dhe konsulton NJMP-në kur është e nevojshme) dhe i ri-dërgon. NJMP-ja miraton VM nëse është e kënaqur me cilësinë dhe pajtueshmërinë me PMSM-në dhe rregullimin kombëtar. 3-5 listat e para kontrolluese të PMSM-së dhe të gjitha PMSM-të specifike për vendpunishten janë subjekt i miratimit nga ana e BB-së.

HAPI 4: Të gjitha NM-të (qoftë nëse kërkohet sipas BB-ë qoftë rregullore kombëtare) do të konsultohen në përputhje me politikat kombëtare dhe të BB-së (siç përcaktohet në kapitullin Shpallja dhe Konsultimet).

HAPI 5: Aplikuesi përfshin komentet relevante të konsultimit në NM, pas së cilave dokumenti është përfundimtar. Rekomandimet e dhëna në vlerësim pasqyrohen më tej në planin e nënprojektit dhe planin e zbatimit, duke përfshirë kostot e vlerësuara të lidhura. Kontrata e granteve me Aplikuesin nuk mund të nënshkruhet para finalizimit të NM-ve (PMSM dhe Listës kontrolluese PMSM). NM-ja (PMSM dhe Lista kontrolluese PMSM) bëhet pjesë e dokumentacionit të tenderimit dhe kontraktimit të punimeve (përgjegjësi e institucioneve që prokurojnë punët).

HAPI 6: Kontraktuesi zbaton NM-në. Institucioni që siguron punimet (MAPL-ja ose Aplikuesi/përfituesi përfundimtar, p.sh. OJQ-ja), monitoron zbatimin e planit të zbutjes dhe monitorimit të NM-së dhe raporton rregullisht tek NJMP-ja (Konsulenti Mjedisor). NJMP-ja mbikëqyr zbatimin e NM-së (duke përfshirë edhe vizitat në terren) dhe i raporton BB-së në zbatimin e NM-së dhe raportet e progresit të projektit (dhe raportet e zbatimit të PMSM-së për projekte specifike nëse është rënë dakord paraprakisht me Specialistin Mjedisor të BB-së), në përputhje me orarin e raportimit.

Mekanizmi i Korrigjimit të Shqetësimeve

Projekti SYILD do të krijojë MKSH-në brenda 6 muajve nga efektiviteti i projektit për të adresuar çdo shqetësim që lidhet me projektin që mund të sjellë dikush. Projekti do të krijojë një faqe interneti të projektit ku do të jenë të disponueshme të gjitha informatat përkatëse të projektit, siç janë raportet e progresit, raportet e masave mbrojtëse, ngjarjet, aktivitetet etj. Faqja e internetit e projektit do të ketë informata kontaktuese të specialistit të stafit të NJMP/Projektit ose stafit të ministrisë, ku mund të paraqiten ankesat si dhe përshkrimi dhe procedurat e MKSH-së. Mundësia për të paraqitur ankesë përmes faqes së internetit do të komunikohet gjithashtu përmes sesioneve informuese të Projektit, konsultimeve publike dhe tryezave të rrumbullakëta të komunitetit me të gjithë akterët e interesuar, përmes mediave sociale (një faqe në Facebook) dhe do të paraqitet në materialet e publicitetit (p.sh. komunikata për media, blogje) dhe materialet e shtypura të realizuara në kuadër të Projektit. Përveç kësaj, informacioni rreth MKSH-së do të jetë i disponueshëm në vendet e qeverisjes lokale ku zbatohen nën-projektet.

Anëtari i stafit përgjegjës NJMP/Ekipi i Projektit do të caktohet për të pranuar dhe për t'iu përgjigjur ankesës. Nëse shqetësimet mund të adresohen nga NJMP-ja, atëherë drejtori i NJMP-së do të ndjekë veprimet që duhet të ndërmerren për të adresuar shqetësimin. Nëse përgjigja e ankesave varet nga institucionet e tjera se sa stafi i NJMP-së (p.sh. MAPL-ja, BB-ja) do të bëjë pyetje dhe do t'i përgjigjet ankuesit. Në rastin kur kriteri i dytë nuk plotësohet në mënyrë të plotë, specialisti i NJMP-së do të vazhdojë të bëjë më shumë hetime (me ose pa kontaktuar ankuesin), si dhe do të zbatoj masat korrigjuese dhe do t'i japë informatë kthyesë ankuesit. Në rast se ankesa është anonime, informatat kthyesë do të jepen në faqen e internetit të Projektit.

Çdo vit, NJMP-ja ka për detyrë të diskutojë në një konsultim publik ankesat e pranuar gjatë vitit dhe të raportojë se cilat masa janë ndërmarrë ose planifikohen të ndërmerren si përgjigje ndaj këtyre informatave kthyesë kritike. Procesverbali i këtij konsultimi do të postohet në faqen e internetit të projektit.

Monitorimi i pajtueshmërisë dhe raportimit të PMSM-së Shpalosja dhe konsultimet

KMMS-ja do të shpaloset në faqen e internetit të MAPL-së në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, për 14 dite, me kopje fizike në dispozicion të publikut në ndërtesë. Në të njëjtën kohë do të publikohet thirrja për konsultim/komente (gjithashtu përmes faqes së MAPL-së), me datën dhe vendin e caktuar për takimin e konsultimeve (ndërtesa e MAPL-së). Gjatë konsultimeve do të kërkohen edhe komentet me shkrim dhe do të sigurohet adresa postare dhe posta elektronike për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve. Të gjitha komentet me shkrim dhe pyetjet e ngritura në konsultimet publike do të adresohen, pastaj do të përmbliidhen (si minuta) dhe do t'i bashkëngjiten KMMS-së si shtojcë. Vetëm atëherë, KMMS-ja mund të konsiderohet si version përfundimtar dhe të përmbyllet.

Procesverbali i konsultimit publik në shtojcën 8 pasqyron procesin dhe rezultatin e konsultimit dhe shpalosjes publike.

PMSM-ja dhe Listat kontrolluese të PMSM-së do të duhet të përgatiten dhe shpalosen në gjuhën angleze dhe shqipe (si dhe serbe në komunat me minoritet serb). Shpalosja do të bëhet përmes faqes së internetit të MAPL-së dhe/ose faqet e internetit të komunave, ku ushtrohet aktiviteti i ndikimit për 14 ditë (kopja fizike do të jetë në MAPL, kati përdhese) si dhe do të mbahet takimin për konsultim publik të KMMS (12 dhjetor 2018, ora 11:00, ndërtesa e Qeverisë/ish ndërtesa e Rilindjes, zyrat e MAPL-së, kati i 13-të, zyra e takimit nr. 1331). Thirrja për komente do të jetë e lëshuar paralelisht. Komentet relevante do të reflektojnë në versionin final të KMMS listën e kontrollit/shtojcë. Krahas KMMS, PMMS do të ndjekë procedurën e konsultimeve të hapura (duke përfshirë edhe takimin e konsultimeve publike)

SHTOJCAT

SHTOJCA 1 - PËRGJEGJËSITË DHE PJESËMARRËSIT KYÇ

Pjesëmarrësit	Aktiviteti	Dokumentacioni mbështetës
MAPL (NJMP)	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e KMMS-së për SYILD, nga MAPL-ja / autoriteti lokal; • Mbikëqyrja e zbatimit të nën-projekteve; • Monitorimi i zbatimit (të PMSM-së dhe/ose Listës kontrolluese të PMSM-së) (duke përfshirë vizitat në teren) dhe sigurimi i masave korrigjuese; • Shqyrtimi mjedisor; • Raportimi në BB rreth zbatimit të KMMS-së (PMSM dhe/ose Lista kontrolluese e PMSM-së); • Përfshirja e të gjitha politikave të masave mbrojtëse të VM-së për të gjithë dokumentet e projekteve/nën-projekteve, si dhe doracakut të nën-projektit; • Koordinimi dhe zbatimi i përgjithshëm i projektit; • Finalizimi i formularit të rishikimit mjedisor; • Përgatitja dhe konsultimi publik i KMMS-së; • Monitorimi/mbikëqyrja dhe vlerësimi i pajtueshmërisë me planet/masat zbutëse të KMMS-së; • Koordinimi me palët e interesit: institucionet, komunat, shoqërinë civile, OJQ-të, Iniciativat rinore; Koordinimi me donatorët tjerë gjatë zbatimit të projektit. 	<ul style="list-style-type: none"> • KMMS; • PMSM/Lista kontrolluese e PMSM me planin monitorues me shtojcat mbështetëse; • Raportet periodike dhe raporti i përfundimit të nën-projektit; • Raportimi mjedisor Brenda raporteve të rregullta të progresit; Raportet periodike të monitorimit.
Aplikuesi (përfituesi i fundit)	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e Pyetësorit të Mjedisit; • Përgatitja e AE, duke përfshirë planin e monitorimit; • Sigurimi i implementimit të EA; • Raportimi i zbatimit të EA tek PMU; • Mbajtja e dokumenteve dhe të dhënave mjedisore (p.sh. vendimi i komunës për vendndodhjen e deponise se mbeturinave, menaxhimi e mbeturinave etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet e raportimit • Partneriteti i bazuar në MM; • Dokumenti i MM-së i nënshkruar midis MAPL-së dhe secilës nga 10 komunat e përzgjedhura;
BB (IBRD)	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi i stafit të NJMP/MAPL-së në lidhje me KMMS /procedurat e rishikimit mjedisor, • Realizimi i shqyrtimeve paraprake dhe pasuese Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së përgjithshme mjedisore të zbatimit të Projektit 	<ul style="list-style-type: none"> • Statusi i dokumentit të zbatimit të projektit në Raportet e Statusit dhe Rezultateve të Zbatimit dhe Përkujtesat e misionit

SHTOJCA 2 - PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT MJEDISOR DHE SOCIAL PËR INFRASTRUKTURË (madje edhe për infrastrukturë të vogël)

Emri i seksionit: _____

Nr.	Pyetjet rreth rrezikut mjedisor	Po/Jo	Të panjohura	Hollësitë/Shënimet
1	Çfarë lloj punimesh do të kontraktohen për aktivitetet e nën-projektit?			
2	A do të ketë vetëm punë/riparime të lehta apo ndonjë lloj tjetër aktivitetesh?			
3	A do të realizohet instalimi i pajisjeve apo riparimeve të tjera të vogla në kuadër të nën-projektit dhe cila do të jetë natyra e tij?			
4	Nëse përdorni hapësirat ekzistuese, ju lutemi jepni përshkrim të hollësishëm se cilat janë ato dhe si do t'i përdorni ato.			
5	Nëse nënprojekti është pjesë e infrastrukturës së re të planifikuar, ju lutemi jepni një përshkrim të hollësishëm se cilat janë ato dhe si.			
6	A është seksioni (nënprojekti) i vendosur në zonën e mbrojtur?			
7	A shfrytëzohet kjo zone nga speciet e mbrojtura ndonjëherë gjatë vitit (pavarësisht se a është ZM apo jo)?			
8	Çfarë lloji i zonës së mbrojtur është ky? (niveli dhe arsyeja për mbrojtje)			
9	A është nënprojekti i vendosur ose a ka gjasa që të ndikojë në vendin e trashëgimisë arkeologjike apo kulturore?			
10	A është terreni i vend punishtes: <ul style="list-style-type: none"> - Bregdetar, - Urban, - Bujqësor, - Industrial, - Të tjera specifike - specifikoni në kolonën e 'Shënimeve'? 			
11	A ka ndonjë problem me te drejtën e kalimit apo ka nevojë për blerje të tokës?			
12	A kërkon nënprojekti leje mjedisore, VNM ose lloj tjetër të VM sipas legjislacionit kombëtar?			
13	A kërkon nën-projekti konsultime specifike publike sipas legjislacionit kombëtar?			
14	A pritet të ketë gjenerime të sasive më të mëdha të mbeturinave të rrezikshme (si azbesti, llambat kompakte fluoreshente, mbetjet e bojërave të plumbit, pajisjet e kontaminuara me naftë / lëndë djegëse si kaldaja e vjetër ose rezervuarët e naftës etj.) ose lloje të veçanta të mbeturinave (shufrat ndriçuese radioaktive) si rezultat i nënprojektit?			
15	A do kete prokurim te kemikaleve?			
15	Shënime/çështje tjera			

SHTOJCA 3 –FORMA E LISTËS KONTROLLUESE TË PLANIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Hyrje

Projekti do të arrijë objektivin e saj të zhvillimit në lidhje me përfshirjen socio-ekonomike të të paktën 3,000 të rinjve të marginalizuar (moshat 15-29 vjeç) në komunitetet e rrezikuara në Kosovë përmes aktiviteteve të angazhimit qytetar

Projekti do të arrijë objektivin e zhvillimit socio-ekonomik nëpërmjet tri komponentëve:

1. Zhvillimin e komunitetit të udhëhequr nga ana e rinisë;
2. Trajnimin e akterëve të rinj;
3. Menaxhimin dhe administrimin e projekteve, M & V dhe shpërndarja e dijës.

Përveç aktiviteteve të buta siç janë: mbajtja e trajnimeve për grupet e akterëve të rinj të marginalizuar, OJQ-të/individët pa përvojë me qëllim të zhvillimit të aftësitë e tyre etj., të cilat nuk priten të kenë ndonjë ndikim negativ mjedisor, aktivitetet në kuadër të Komponentit të parë: Zhvillimin e Komunitetit nga të rinjtë gjithashtu parasheh punë ndërtimore të vogla të tilla si rinovimet, riparimet dhe punë të ngjashme. Kjo listë kontrolluese e PMMS-së parasheh masa mjedisore dhe planin e monitorimit për këto punë që adresojnë ndikimet tipike dhe të lokalizuara.

Ndikimet potenciale mjedisore

Ndikimet e përgjithshme mjedisore të Projektit priten të jenë të menaxhueshme, të përkohshme dhe lokale, pasi ato lidhen me punë të vogla ndërtimore ose të dheut kryesisht në zonat urbane. Këto ndikime më së shpeshti përfshijnë, por nuk kufizohen në: a) pluhurin dhe zhurmën për shkak të gërmimeve, transportit, rrënimin dhe rregullimit; b) Menaxhimi i mbeturinave të ndërtimit c) emetimet akustikë d) rreziqet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë.

Aktivitetet e nën-projektit dhe ndikimet mjedisore

Lista kontrolluese e PMMS-së

Lista e kontrollit PMMS aplikohet për rregullime ose ndërtim të vogël të objekteve. Kjo listë siguron "praktikë të mirë pragmatike" dhe është e dizajnuar për të qenë lehtë e përdorshme dhe në përputhje me kërkesat mbrojtëse të BB-së. Format i llojit të listës kontrolluese tenton të mbulojë qasjet tipike zbutëse për kontratat e zakonshme të punëve ndërtimore me ndikime të lokalizuara.

Lista kontrolluese përbëhet nga pjesa hyrëse dhe tri pjesë kryesore:

- Hyrja ose parathënia në të cilat prezantohet projekti, përcaktohet kategoria e mjedisit dhe sqarohet lista e kontrollit të PMMS-së.
- **Pjesa 1** përbën një pjesë përshkruese ("pasaportë punishteje") që përshkruan specifikat e projektit në aspektin e vendndodhjes fizike, aspektet institucionale dhe legislative, përshkrimin e projektit, përfshirjen e nevojës për një program të ngritjes së kapaciteteve dhe përshkrimin e procesit të konsultimit publik.
- **Pjesa 2** përfshin shqyrtimin mjedisor dhe social në një format të thjeshtë me Po/Jo e ndjekur nga masat zbutëse për çdo aktivitet të dhënë.

- **Pjesa 3** është një plan monitorimi për aktivitetet gjatë ndërtimit dhe zbatimit të projektit. Ajo mban të njëjtin format të kërkuar për PMMS-të e Bankës Botërore. Qëllimi i kësaj liste kontrolluese është që Pjesa 2 dhe Pjesa 3 të përfshihen si dokumente ofertuese për kontraktorët.

Lista Kontrolluese e PMMS (Pjesët 1-3) do të përditësohet dhe plotësohet për secilin nën-projekt sipas nevojës për t'u përputhur me PMMS-në.

Aplikimi i Listës kontrolluese PMS

Procesi i dizajnit të punëve ndërtimore të parapara në kuadër të Projektit do të zhvillohet në tri faza:

- 1) *Faza e përgjithshme e identifikimit dhe studimit*, në të cilën përzgjidhen vendndodhjet ose objektet (p.sh. qendrat rinore, etj.) për rehabilitim dhe shtjellohet një program i përafërt për tipologjitë e mundshme të punës. Në këtë fazë, plotësohen Pjesët 1, 2 dhe 3 të listës kontrolluese PMMS. Pjesa 2 e listës kontrolluese mund të përdoret për të përzgjedhur aktivitetet tipike nga një "menu" dhe t'i lidhin ato me çështjet tipike mjedisore dhe masat zbutëse.
- 2) *Faza e detajuar e dizajnit dhe tenderimit*, duke përfshirë specifikimet dhe kushtet. Lista Kontrolluese PMMS rishikohet sipas detajeve të njohura të projektimit në këtë fazë. Si e tillë, lista kontrolluese i paraqitet publikut, përpara procedurës së tenderimit. Kjo fazë gjithashtu përfshin tenderin dhe dhënien e kontratave të punëve. Pasi të jetë plotësuar tërësisht në PMMS-në në formë tabelore (Pjesa 1, 2 dhe 3) duhet të bashkëngjitet si pjesë përbërëse e kontratës së punëve, si dhe kontrata mbikëqyrëse duhet të nënshkruhet nga palët e kontraktuara, ngjashëm me të gjitha kushtet teknike dhe tregtare.
- 3) *Gjatë fazës së zbatimit të punëve*, kontrollohet përputhshmëria mjedisore në vend punishten përkatëse nga inspektori(ët)/mbikëqyrësi(it) e certifikuar, të cilët përfshijnë inxhinierin mbikëqyrës të vend punishtes dhe / ose konsulentin mjedisor në NJMP dhe shërbimet përkatëse të inspektimit nga Ministria e Mjedisit. Masat zbutëse në pjesën 2 dhe plani i monitorimit në Pjesën 3 janë bazat për të verifikuar përputhshmërinë e Kontraktuesit me dispozitat e kërkuara mjedisore.

Monitorimi dhe Raportimi

Me qëllim të monitorimit të kujdesit adekuat të vendosur nga masat mbrojtëse të Kontraktorit, inxhinieri përgjegjës për mbikëqyrjen e vend punishtes do të punojë me pjesën 3 të Listës Kontrolluese të PMSM, përkatësisht me planin monitorues. Pjesa 3 është vend punishtja e zhvilluar specifikisht nga shfrytëzuesi i fondeve dhe në detajet e nevojshme, duke definuar në mënyrë të qartë masat zbutëse dhe monitorimin që mund të futet në kontratat e punëve, të cilat pasqyrojnë praktikën mjedisore në vend punishte dhe të cilat mund të vëzhgohen/maten/kuantifikohen/verifikohen nga inspektori gjatë punimeve të ndërtimit.

Kështu, Pjesa 3 do të përditësohet dhe rishikohej gjatë procesit të hartimit për të pasqyruar praktikisht kriteret kyçe të monitorimit që mund të kontrollohen gjatë dhe pas punimeve për sigurimin e përputhshmërisë dhe në fund pagesën e Kontraktorit.

PJESA 1: PJESA INSTITUCIONALE DHE ADMINISTRATIVE	
Vendi	
Titulli i projektit	
Fushëveprimi i projektit dhe aktivitetit	

Marrëveshjet institucionale (Emri dhe informatat kontaktuese)	Menaxhimi i projektit	
Marrëveshjet e zbatimit (Emri dhe informatat kontaktuese)	Mbikëqyrja	
PËRSHKRIMI I VENDPUNISHTES		
Emri i vendpunishtes		
Përshkruani lokacionin e vendpunishtes		Shtojca 1: Informacioni mbi vendpunishten (shifrat nga vendpunishtja) []Po [] Jo
Kush është në pronësi të tokës?		
Përshkrimi gjeografik		
LEGJISLACIONI		
Identifikoni legjislacionin kombëtar dhe lokal dhe lejet që zbatohen për aktivitetin e projektit		
KONSULTIMI PUBLIK		
Identifikoni kur/ku zhvillohet procesi i konsultimit publik		
NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE		
A do të ketë ndonjë aktivitet për ngritje të kapaciteteve?	[] Jo ose []Po nëse po, Shtojca 2 përfshin informacione për ngritjen e kapaciteteve	

PJESA 2: SHQYRTIMI MJEDISOR/SOCIAL

A do të përfshijë aktiviteti në vendpunishte ndonjë nga këto pikat në vijim:	Aktiviteti	Statusi	Referenca të tjera
	A. Kërkesa të përgjithshme për të gjitha punimet	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih Seksionin A më poshtë
	B. Rehabilitimin e ndërtesave	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih Seksionin A, B më poshtë
	C. Rehabilitimin e parqeve	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih Seksionin A, C më poshtë
	D. Blerjen e Kimikateve	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	Shih Seksionin A, D më poshtë

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
A. Kushtet e Përgjithshme	Njoftimi dhe Siguria e Punëtorëve	<ul style="list-style-type: none"> a) Ofrimi i informatave tek popullsia lokale rreth fushëveprimit dhe kohës së fillimit dhe kohëzgjatjes së aktiviteteve të ndërtimit duke përgatitur Njoftimin që do të vendoset në tabelën e njoftimeve të komunës dhe në faqen e internetit të komunës dhe përmes mjeteve tjera, nëse është e nevojshme, për t'u siguruar se popullsia lokale është e informuar mirë; b) Inspektoratet lokale të ndërtimit dhe ato të mbrojtjes mjedisore/të natyrës janë të informuara për punimet para fillimit; c) Të gjitha lejet/opinionet e nevojshme merren para fillimit të punimeve (duke përfshirë atë të ndërtimit dhe të tjera); d) Të gjitha punët do të kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar; e) Rrobat dhe pajisjet mbrojtëse personale të punëtorëve janë në dispozicion në sasi të mjaftueshme dhe vishen/përdoren gjatë gjithë kohës; f) Punëtorët duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe me përvojë adekuate për punën që kryejnë (p.sh. për punimet në lartësi); g) Gropat e hapura mbuloohen dhe shënohen qartë kur nuk punohet në to; h) Të sigurohet shënimi përkatës dhe tabela informative e vendit të rindërtimit i) Shënimi i vendpunishtes për ruajtjen e përkohshme të materialit për rindërtim afër vendpunishtes j) Sigurimi i shiritave të paralajmërimit, rrethojave dhe shenjave përkatëse që paralajmërojnë rrezik, rregullat kyçe dhe procedurat që duhet të ndiqen.

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
		<ul style="list-style-type: none"> k) Hyrja e ndaluar e personave të papunësuar brenda shiritave të paralajmërimit dhe rrethojave kur/ku shihet e nevojshme. l) Zona rrethuese afër sallës sportive duhet të mbahet e pastër m) Makinat duhet të operohen vetëm nga personeli i trajnuar dhe me përvojë, duke zvogëluar kështu rrezikun e aksidenteve; n) Të gjithë punëtorët duhet të njihen me rreziqet e zjarrit dhe masat për mbrojtje nga zjarri dhe duhet të jenë të trajnuar për të operuar me fikësit e zjarrit, hidrantët dhe pajisjet tjera që përdoren për shuarjen e zjarrit o) Aparatet, pajisjet dhe fikësit e zjarrit duhet të jenë gjithmonë funksionale, kështu që në rast nevoje, mund të përdoren me shpejtësi dhe efikasitet. Kutitë e ndihmës së parë duhet të jenë në dispozicion në vendpunishte dhe personeli i trajnuar për ta përdorur. p) Procedurat për rastet e emergjencës (duke përfshirë derdhjet, aksidentet etj.) janë në dispozicion në vendpunishte. q) Duhet të sigurohen pajisjet sanitare (tualetet) për punëtorët. r) Pajisjet e blera do të instalohen dhe përdoren duke respektuar të gjitha masat e sigurisë të përshkruara nga prodhuesi i pajisjeve dhe praktikat më të mira.
	Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> a) Vendi i ndërtimit, rrugët e transportit dhe vendet e trajtimit të materialeve duhet të spërkaten me ujë në ditë të thata dhe me erë. b) Materialet e ndërtimit duhet të ruhen në vende të përshtatshme të mbuluara për të minimizuar pluhurin c) Ngarkesat e automjeteve që kanë gjasa të lëshojnë pluhur duhet të mbulohen. d) Kufizimi i shpejtësisë së automjetit në vendin e rindërtimit. e) Rrugët fshihen dhe pastrohen rregullisht në pika kritike. f) Mbajeni shtresën e punueshme dhe rezervat e ndara. Mbroni me fleta/rrethoja në rast të motit me erë. g) Lokalizoni rezervat larg linjave të drenazhit, rrugët ujore natyrore dhe vendet e ndjeshme ndaj erozionit tokësor. h) Të gjitha ngarkesat e tokës mbulohen kur hiqen nga vendpunishtja për deponim. i) Të sigurohet që të makineritë dhe automjetet e transportit janë pajisur me pajisjet e duhura të kontrollit të emetimeve, mirëmbahen rregullisht dhe provohen. j) Të sigurohet që të gjitha makineritë dhe automjetet përdorin benzinë nga burimet zyrtare (stacionet e licencuara të benzinës) dhe me lëndën djegëse të përcaktuar nga prodhuesi i makinerive dhe automjeteve.

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
	Menaxhimi i transportit dhe materialeve	<p>k) Nuk do të ketë lëvizje të tepruar të automjeteve ndërtimore në vendpunishte.</p> <p>a) Agregati i trashë në beton dhe mbushja e llogoreve të aplikuara dhe të përdorura në rehabilitim duhet të jetë në përputhje me kërkesat e qëndrueshmërisë dhe gradimit. Agregati duhet të jetë virgjëror (i papërdorur më parë) dhe mundësisht i prodhuar në vend.</p> <p>b) Burimet minerale (agregatet, rëra, zhavorri etj.) prodhohen vetëm nga kompanitë e licencuara me koncesione të vlefshme për nxjerrje/shfrytëzim. Kompanitë mund të dëshmojnë se masat e H&S janë në vend.</p>
	Zhurma	<p>a) Duke qenë zonë urbane banimi (<u>ngasja nëpër qytet në vend punishte</u>), niveli i zhurmës nuk duhet të tejkalojë 55dB gjatë ditës dhe mbrëmjes dhe 45dB gjatë natës</p> <p>b) Puna e ndërtimit nuk do të lejohet gjatë netëve, operacionet në vend punishte do të kufizohen nga ora 7:00 deri në ora 19:00 (dakorduar në leje).</p> <p>c) Gjatë operacioneve, mbështjellësit e motorëve të gjeneratorëve, kompresorëve të ajrit dhe pajisjeve tjera mekanike të fuqizuara duhet të jenë të mbyllura, dhe pajisjet të jenë të vendosura sa më larg zonave të banimit që është e mundur.</p> <p>d) Pompat dhe pajisjet e tjera mekanike duhet të mirëmbahen në mënyrë efektive.</p>
	Cilësia e ujit dhe tokës	<p>a) Parandalimi i derdhjeve të rrezikshme që vijnë nga mbeturinat (magazinimi i përkohshëm i mbeturinave duhet të jetë i mbrojtur nga rrjedhjet dhe ato për mbetjet e rrezikshme ose toksike të pajisura me sistem sekondar të mbrojtjes, p.sh. kontejnerët me mur të dyfishtë ose me shirita).</p> <p>b) Nëse ndodh një derdhje e rrezikshme, ndalojeni dhe hiqeni atë, pastroni vendin dhe ndiqni procedurat dhe masat për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.</p> <p>c) Në rast të ndonjë rrjedhjeje që vjen nga zona e punimeve eventualisht e ndotur nga substanca të rrezikshme do të mblidhet në vend në një pellg të përkohshëm mbajtjeje dhe do të bartet në një impiant të përshtatshëm të licencuar për trajtimin e ujërave të zeza.</p> <p>d) Instalimi/sigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të përshtatshme sanitare për punëtorët. Ujërat e zeza nga këto burimet duhet të barten në impiante të përshtatshme për trajtimin e ujërave të zeza.</p> <p>e) Parandalimi i derdhjeve të rrezikshme që vijnë nga rezervuarët (sistemi sekondar i detyrueshëm i mbrojtjes, p.sh. kontejnerët</p>

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
		<p>me mure të dyfishta ose ata me shirita), pajisjet dhe automjetet e ndërtimit (mirëmbajtja dhe kontrolli i rregullt i rezervuarëve të naftës dhe gazit, makineritë dhe automjetet mund të parkohen (manipulohen) vetëm në sipërfaqe të asfaltuara ose betonuara me sistem të mbledhjes së ujërave nga rrjedhjet sipërfaqësore.</p> <p>f) Rrjedhjet nga lokacioni punues me ngarkesë të materieve të suspenduara duhet të filtrohen para derdhjes në rrjedha natyrore.</p> <p>g) Uji, dhe komponentët tjera, në përzierjet e betonit duhet të jenë të pastra dhe të mos përmbajnë kimikate.</p>
	Menaxhimi mbeturinave	<p>i</p> <p>Praktika e mirë e menaxhimit të mbeturinave do të zbatohet duke përfshirë:</p> <p>a) Identifikimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave që mund të gjenerohen në vendin e rindërtimit dhe klasifikimi i tyre sipas Ligjit Nr. 04/L-060 (Ligji për Mbeturinat)</p> <p>b) Kontejnerët për secilën kategori të mbeturinave të identifikuar sigurohen në sasi të mjaftueshme dhe pozicionohen në mënyrë të përshtatshme.</p> <p>c) Do të identifikohen rrugët e grumbullimit dhe deponimit dhe deponitë/impianetet përpunuese të licencuara për të gjitha llojet kryesore të mbeturinave që priten nga aktivitetet e shkatërrimit dhe ndërtimit. Për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme do të kërkohen dhe ndiqen udhëzimet / manualët nga Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</p> <p>d) Mbeturinat minerale (natyrale) të ndërtimit dhe shkatërrimit do të ndahen nga mbeturinat e përgjithshme skarco, organike, të lëngshme dhe ato kimike nga klasifikimi në terren dhe do të ruhen përkohësisht në kontejnerë të përshtatshëm. Varësisht nga origjina dhe përmbajtja, mbeturinat minerale do të riaplikohen në vendndodhjen e tyre origjinale ose do të ripërdoren.</p> <p>e) Të gjitha mbeturinat e ndërtimit do të grumbullohen dhe deponohen siç duhet nga grumbulluesit e licencuar dhe tek deponitë e licencuara (ose impianetet përpunuese të licencuara).</p> <p>f) Shënimet e deponimit të mbeturinave do të përditësohen rregullisht dhe do të mbahen si dëshmi për menaxhimin e duhur, siç janë dizajnuar.</p> <p>g) Kurdo që është e mundur, kontraktuesi do të ripërdorë dhe riciklojë materialet e duhura dhe të qëndrueshme. Hedhja e çdo lloj mbeturine (duke përfshirë ato organike) ose ujërave</p>

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
		<p>të zeza në natyrën përreth ose trupat ujqor është rreptësisht e ndaluar.</p> <p>h) Grumbullimi, bartja dhe deponimi/përpunimi final i mbeturinave komunale nga një kompani e licencuar;</p> <p>i) Mbeturinat e ndërtimit duhet të largohen menjëherë nga vend punishtja dhe të ripërdoren nëse është e mundur;</p> <p>j) Ndalohet djegia e të gjitha mbeturinave në vend punishte ose impiante të pa licencuara dhe lokacione.</p> <p>k) Vendi i deponimit të mbeturinave do të përcaktohet me miratim me shkrim nga Komuna ose autoriteti tjetër kompetent (p.sh. MMPH).</p> <p>l) Njësitë ekzistuese të kondicionimit të ajrit nuk duhet të rimbushen ose zbrazen. Nëse hidhen, duhet të trajtohen nga kompani të specializuara të licencuara.</p>
	Siguria e trafikut	<p>a) Plani i rregullimit të trafikut përgatitet dhe zbatohet në koordinim me Komunën dhe autoritetin kompetent (policia e trafikut);</p> <p>b) Trafiku do të rregullohet në mënyrë të sigurt. Siguria e këmbësorëve do të arrihet nëpërmjet përdorimit të vendkalimeve të sigurta.</p> <p>c) Njoftimi i sigurisë dhe rregullimit, shenjat dhe sinjalizimi do të përdoren në mënyrë të përshtatshme.</p>
	Erozioni i tokës	<p>a) Në rastin e derdhjeve, uji i ndotur duhet të futet në kontejner për të parandaluar kontaminimin e mëtejshëm dhe të transportohet në një impiant për trajtimin e ujërave të zeza.</p> <p>b) Automjetet dhe makineritë mund të parkohen, lahen dhe mirëmbahen vetëm në zonat e përcaktuara me sipërfaqe të papërshkueshme me një sistem grumbullimi dhe trajtimi (ndarës të vajit dhe yndyrës),</p> <p>c) Mbrojtja e sedimenteve të përhapura nga rrethojat dhe barrierat.</p>
	Gjetje të rastësishme arkeologjike të çfarëdo artefakteve kulturore dhe historike	<p>a) Zona e punës, kampi i vend punishtes, etj. duhet të vendoset larg nga vendet e trashëgimisë dhe ato arkeologjike.</p> <p>b) Kujdes dhe ndërgjegjësim adekuat do të merren për të udhëzuar punëtorët e ndërtimit për zbulimin e mundshëm të relikteve arkeologjike;</p> <p>c) Punimet do të ndalen, autoritetet përgjegjëse njoftohen në përputhje me rregulloren kombëtare dhe udhëzimet e tyre të ndjekura. Punimet do të fillojnë përsëri vetëm pasi</p>

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
	Magazinimi i materialeve të papërshtatshëm toksike (përfshirë mbeturinat e rrezikshme) dhe përdorimi mund të shkaktojë ndotje të ajrit, tokës ose ujit	<p>autoritetet përkatëse të kenë dhënë udhëzimet dhe autorizimin e tyre.</p> <p>a) Ruajtja e të gjitha materialeve në kontejnerë origjinalë në lokacione adekuate, që lejojnë ruajtjen nga depërtimi i rrjedhjes dhe në kontejnerë të mbrojtur nga rrjedhjet.</p> <p>b) Nuk do të ketë ruajtje të një sasive të madhe të lëndëve djegëse në vend punishte.</p> <p>c) Të sigurohet që punëtorët janë të familjarizuar me rregulloret e sigurisë dhe kërkesat e ruajtjes për secilin produkt.</p> <p>d) Të sigurohen absorbues për derdhjet në vend. Në rast të një aksidenti, ndaloni derdhjen dhe riparoni vendin. Mbeturinat duhet të trajtohen si të rrezikshme.</p> <p>e) Ndiqni udhëzimet e MSDS gjatë trajtimit të kimikateve;</p> <p>f) Kimikalet dhe mbeturinat e rrezikshme janë vendosur në vende të sigurte dhe sigurohen që të mos rrjedhin.</p>
	Gatishmëria për emergjenca	<p>a) Përgatitet Plani i Gatishmërisë për Emergjenca dhe i komunikohet punonjësve.</p> <p>b) Të sigurohet njohja me rrjetet në afërsi të vendit.</p> <p>c) Në rast të ndërprerjeve aksidentale, ndaloni menjëherë të gjitha punimet, njoftoni autoritetet e duhura në rajon dhe riparimin emergjent të rrjetit të dëmtuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe Planin e Gatishmërisë për Emergjenca.</p> <p>d) Sigurimi i pajisjeve të zjarfikësve dhe trajnimit për punonjësit</p>
B. Rehabilitimi i ndërtesave	Siguria e komunitetit	<p>a) Sigurimi i sigurisë së përdoruesve të ndërtesave, p.sh. të sigurohen vendkalimet e sigurta dhe mbrojtja nga objektet që bien.</p> <p>b) Të informohen me kohë shfrytëzuesit e objekteve dhe komunitetet fqinje për punimet e ardhshme.</p> <p>c) Në rast të ndërprerjes së trafikut, të organizohen rrugë alternative në bashkëpunim me Komunën.</p>
C. Rehabilitimi i parqeve	Mbrojtja e natyrës	<p>a) Ndalohet rreptësisht gjuetia ilegale, shqetësimi i kafshëve, grumbullimi i barishteve dhe ushqimit pyjor.</p> <p>b) Zjarret e hapura janë rreptësisht të ndaluara.</p> <p>c) Nuk do të ketë shpërndarje të mbeturinave.</p>

AKTIVITETI	PARAMETRI	LISTA E KONTROLLIT TË MASAVE ZBUTËSE
		<ul style="list-style-type: none"> d) Para punimeve, zona duhet të kontrollohet për strofulla dhe fole. e) Minimizoni zonën e punës dhe përdorni vetëm atë që është e nevojshme. f) Nuk lejohet asnjë prerje e drunjve. Nëse është e pashmangshme, duhet të merret një leje nga autoriteti kompetent. g) Vetëm bimët vendore mund të përdoren në ri mbjellje. h) Të gjitha mbeturinat dhe materialet tjera si dhe pajisjet duhet të hiqen kur të përfundojnë punimet; i) Shmangni punimet gjatë sezonit të ngritjes së foleve/shturjes.
D. Blerja e Kimikateve		<ul style="list-style-type: none"> a) Kimikatet blihen vetëm nga distributori i licencuar. b) Pesticidet nuk blihen. c) Kimikatet vendosen në një vend të sigurt dhe jo të rrezikuar nga derdhja. d) Kimikatet menaxhohen dhe përdoren në përputhje me Listat e të Dhënave të Sigurisë së Materialit, (LDHSM) dhe trajtohen vetëm nga personeli i trajnuar dhe me përvojë.

PJESA 3: PLANI I MONITORIMIT

Faza	Cili (parametër do të monitorohet?)	Ku (është parametri që do të monitorohet?)	Si (është parametri që do të monitorohet?)	Kur (Përcaktoni shpeshësinë / vazhdimësinë?)	Pse (po monitorohet parametri?)	Kostoja (nëse përfshihet buxhetin projektit)	Kush (është përgjegjës për monitorim?)
Përgatitja	Të gjitha lejet e nevojshme janë marrë para fillimit të punimeve.	Në administratën e qytetit	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Para fillimit të punimeve	Për sigurimin e aspekteve ligjore të aktiviteteve të rehabilitimit	/	Mbikëqyrësi i punimeve (p.sh. inxhinieri mbikëqyrës apo ndonjë person tjetër i autorizuar/emëruar), NJMP
	Janë njoftuar institucionet publike dhe relevante	Lokalet e kontraktuesit	Inspektimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme	Para fillimit të punimeve	Për sigurimin e vetëdijesimit të publikut	/	Mbikëqyrësi i punimeve (p.sh. inxhinieri mbikëqyrës apo ndonjë person tjetër i autorizuar/emëruar), NJMP
	Masat e sigurisë për punëtorët, punonjësit dhe vizitorët	Në vendin e ndërtimit	Kontrolle vizuale dhe raportim	Para fillimit të punimeve	Për parandalimin e rreziqeve ndaj shëndetit dhe sigurisë - lëndimeve mekanike dhe ofrimin e qasjes dhe lëvizjes së sigurt	/	Mbikëqyrësi i punimeve (p.sh. inxhinieri mbikëqyrës apo ndonjë person tjetër i autorizuar/emëruar), NJMP
Zbatimi	Rrjedha e sigurt e trafikut dhe siguria e këmbësorëve	Në vendin e ndërtimit	Kontrolle vizuale dhe raportim	Kontrolle të rastësishme	Për të siguruar rrjedhën e koordinuar të trafikut	/	Mbikëqyrësi

	Siguria në punë	Në vendin e ndërtimit	Kontrolle vizuale dhe raportim Inspektime pa paralajmërim gjatë punimeve	Kontrolle të rastësishme	Për parandalimin e rreziqeve ndaj shëndetit dhe sigurisë - lëndimeve mekanike dhe ofrimin e qasjes dhe lëvizjes së sigurt	/	Mbikëqyrësi
	Vendi i ndërtimit është i organizuar mirë: ka rrethoja, paralajmërim, shenja.	Në vendin e ndërtimit	Inspektim	Kontrolle të rastësishme	Për parandalimin e aksidenteve /	/	Mbikëqyrësi
	Mbledhjen dhe transportin e mallrave të rrezikshme (nëse ka)	Në lokacionin e përkohshëm të sigurt në vendin e ndërtimit në kontejnerë të veçantë të mbeturinave	Inspektimi i listave të transportit dhe kushteve të kontejnerëve dhe hapësirave të ruajtjes	Kontrolle të rastësishme	Për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal dhe kombëtar / Mbeturinat e rrezikshme nuk duhet të hedhen në çfarëdo deponie	/	Mbikëqyrësi
	Mbledhja, transporti dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave të ngurta	Në vendin e ndërtimit dhe përreth tij	Monitorimi vizual dhe inspektimi i listave të transportit të kontraktorit	Kontrolle të rastësishme	Për të shmangur mbetjen e mbeturinave të ngurta në vendin e ndërtimit dhe për shmangien e ndikimit negativ në mjedisin lokal dhe shëndetin e banorëve lokal	/	Mbikëqyrësi
	Ndotja e ajrit Parametrat e pluhurit, grimcave	Në vendin e ndërtimit dhe përreth tij	Inspektimi vizual për pluhur	Kontrolle të rastësishme, Pas ankesës apo të gjeturave negative nga inspektimi	Për të siguruar se nuk emetime të tepërta gjatë punimeve	/	Mbikëqyrësi
	Niveli i zhurmës	Në vendin e ndërtimit dhe përreth tij	Monitorimi i nivelit të zhurmës dB (me pajisje të përshtatshme)	Pas ankesës apo nga të gjeturat e inspektimit	Për të përcaktuar nëse niveli i zhurmës është mbi apo nën nivelin e lejueshëm të zhurmës	/	Mbikëqyrësi

Operimi	Menaxhimi i mbeturinave	Në vendin e ndërtimit dhe përreth tij	Kontrolle vizuale dhe të dokumenteve	Rregullisht	Në vendin e ndërtimit ka numër të mjaftueshëm të kontejnerëve, mbeturinat deponohen në lokacionin e përcaktuar të komunës dhe mbahen shënime për mbeturinat	Aplikuesi	NJMP

ANEKSI 4 - MODELI I PLANIT TË MENAXHIMIT SOCIAL DHE MJEDISOR

Plani i menaxhimit social dhe mjedisor (PMSM) i një projekti përmban grupin e masave zbutëse, monitoruese dhe institucionale që do të merren gjatë zbatimit dhe operimit për të eliminuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale, për t'i kompensuar ose për t'i reduktuar në nivele të pranueshme. Plani po ashtu përfshin veprimet e nevojshme për të zbatuar këto masa.

Planet e menaxhimit janë elemente thelbësore të raporteve të EA për projektet e kategorisë A; për shumë projekte të Kategorisë B, EA mund të rezultojë vetëm në një plan menaxhimi. Për të përgatitur një plan menaxhimi, pranuesi dhe ekipi i tij i hartimit të EA (a) identifikojnë grupin e përgjigjeve ndaj ndikimeve potencialisht të pafavorshme; (b) përcaktojnë kërkesat për t'u siguruar që ato përgjigje janë bërë në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur; dhe (c) përshkruajnë mjetet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Më konkretisht, PMSM përfshin komponentët e mëposhtëm:

Zbutjen

PMSM identifikon masat e realizueshme dhe me kosto efektive që mund të zvogëlojnë ndikimet negative mjedisore që janë potencialisht të konsiderueshme në nivele të pranueshme. Plani përfshin masat kompensuese nëse masat zbutëse nuk janë të realizueshme, me kosto efektive ose të mjaftueshme. Veçanërisht PMSM;

- (a) Identifikon dhe përmbledh të gjitha ndikimet negative të konsiderueshme mjedisore të parashikuara (përfshirë ato që përfshijnë njerëzit vendas ose ri-sistemimin e pavullnetshëm);
- (b) Përshkruan me detaje teknike çdo masë zbutëse, duke përfshirë llojin e ndikimit me të cilin lidhet dhe kushtet nën të cilat kërkohet (p.sh., vazhdimisht ose në rast të situatave të papritura), së bashku me dizajnet, përshkrimet e pajisjeve dhe procedurat operative, sipas rastit;
- (c) Vlerëson çdo ndikim potencial mjedisor të këtyre masave; dhe
- (d) Siguron lidhje me planet tjera zbutëse (p.sh., për sistemimin e pavullnetshëm, njerëzit vendas ose pronën kulturore) të nevojshme për projektin.

Monitorimi

Monitorimi mjedisor gjatë zbatimit të projektit siguron informata për aspektet kyçe mjedisore të projektit, veçanërisht ndikimet mjedisore të projektit dhe efektivitetin e masave zbutëse. Informacioni i tillë i mundëson pranuesit dhe Bankës vlerësimin e suksesit të zbutjes si pjesë e mbikëqyrjes së projektit dhe lejon marrjen e veprimeve korrigjuese kur nevojitet. Prandaj, PMSM identifikon objektivat e monitorimit dhe specifikon llojin e monitorimit, me lidhje në ndikimet e vlerësuara në raportin e VM dhe masat zbutëse të përshkruara në PMSM. Në mënyrë specifike, seksioni i monitorimit të PMSM siguron (a) një përshkrim specifik dhe detajet teknike të masave të monitorimit, duke përfshirë parametrat që do të maten, metodat që do të përdoren, lokacionet e marrjes së mostrave, frekuencën e matjeve, kufijtë e shpalosjes (aty ku është e përshtatshme), dhe përcaktimin e pragjeve që do të sinjalizojnë nevojën për veprime korrigjuese; dhe (b) procedurat e monitorimit dhe raportimit për (i) sigurimin e zbulimit të hershëm të kushteve që i bëjnë të nevojshme masat e veçanta zbutëse, dhe (ii) japin informacionet për progresin dhe rezultatet e zbutjes.

Plani i Zbatimit dhe Vlerësimet e Kostove

Për të tri aspektet (zbutjen, monitorimin dhe ngritjen e kapaciteteve), PMSM siguron (a) një plan zbatimi për masat që duhet të kryhen si pjesë e projektit, duke treguar fazat dhe koordinimin me planet e përgjithshme të zbatimit të projektit; dhe (b) vlerësimet e kostove kapitale dhe të përsëritura dhe burimet e fondeve për zbatimin e PMSM. Këto shifra janë të integruara edhe në tabelat e kostos totale të projektit.

Plani i zbutjes

Faza e ndërtimit					
Aktiviteti	Ndikimi i pritshëm mjedisor	Masa e propozuar për zbutje	Përgjegjësia për zbatimin e masës zbutëse	Periudha e zbatimit të masës zbutëse	Kostoja e lidhur me zbatimin e masës zbutëse
1.					
2.					
...					
Faza e operimit					
1.					
2.					
...					

Plani i monitorimit

Faza e ndërtimit					
Cili	Ku	Si	Kur	Nga kush	Sa
<i>Parametër do të monitorohet?</i>	<i>Do të monitorohet parametri?</i>	<i>Do të monitorohet parametri (çka duhet të matet dhe si)?</i>	<i>Do të monitorohet parametri (koha dhe frekuenca)?</i>	<i>Do të monitorohet parametri (përgjegjësia)?</i>	<i>ë është kostoja lidhur me zbatimin e monitorimit</i>
1.					
2.					
...					
Faza e operimit					
1.					
2.					

SHTOJCA 5 – PROCESVERBALI I TAKIMIT KONSULTATIV TË KMSM

- I. Publikimi i Kornizës së Menaxhimit Social dhe Mjedisit dhe njoftimi për takimin e hapur publik të shpallur në faqen e internetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, më 30 nëntor 2018, në tri gjuhë (ndiqni linkun në anglisht për këtë dokument), <https://mapl.rks-gov.net>; <https://mapl.rks-gov.net/en/publications/>; Ftesa për takimin për konsultim publik, e 12 dhjetorit është dërguar në 10 komuna të përzgjedhura paraprakisht, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Për më tepër, të gjitha palët e interesuara të përmendura janë kontaktuar me telefon për t'ua rikujtuar atyre për takimin;
- II. Afati për paraqitje publike përfundoi më 14 dhjetor 2018;
- III. Diskutimi publik u mbajt më 12 dhjetor 2018 në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- IV. Agjenda e takimit:
 1. Prezantimi i Kornizës së Menaxhimit të Mjedisit në kopje fizike dhe me prezantim në PPT;
 2. Diskutim publik;
 3. Përmbledhje

Prezantimi i Kornizës së Menaxhimit Mjedisor

KMSM-ja e hartuar u shpjegua që nga fillimi me prezantimin (13 slajde, PPT) dhe pas prezantimit të dokumentit, ai u hap faqe për faqe për diskutim, por kryesisht në pjesët ku pjesëmarrësit donin pak më shumë shpjegime.

Kjo Kornizë e Menaxhimit Social dhe Mjedisit (KMSM) përshkruan procedurat që institucionet zbatuese të caktuara dhe gjithashtu përfituesit duhet të ndjekin gjatë zbatimit të saj në mënyrë që të përmbushin kërkesat e Politikave Mbrojtëse të Bankës Botërore dhe të sigurojnë adresimin adekuat të çështjeve mjedisore dhe të ri-sistemimit që mund të bëhen të nevojshme gjatë rrjedhës së zbatimit të projektit, dhe gjithashtu në përputhje me ligjin kombëtar.

Interesi kryesor nga pjesëmarrësit gjatë takimit ishte në lidhje me ligjet e përmendura në degën kombëtare dhe u propozua gjithashtu që të përfshihet Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Përmbajtja e prezantimit:

- Prezantimi i objektivit të projektit dhe komponentëve të tij;
- Aktivitetet e papërshtatshme;
- Lista e përjashtimit;
- Ekzaminimi Mjedisor;
- Aktivitetet e nën projektit dhe ndikimin në mjedis-lista kontrolluese e PMMS-së
- Politikat e Bankës Botërore që zbatohen për projektin;
- Përmbledhje e Legjislacionit Kombëtar dhe Korniza e Menaxhimit Social të Mjedisit;
- Aplikimi i listës kontrolluese të KMSM-së;

- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Diskutimi publik

- Diskutimi publik përfshinte përgjigjet dhe pyetjet rreth procedurave të KMSM-së, kufizimet dhe mundësitë e saj në kontekstin e veprimeve të planifikuara.
- Diskutimi u mbajt në formë të shkëmbimit të mendimeve, pyetjeve, përgjigjeve, komenteve dhe sqarimeve të pikave nën Projektin/KMSM.
- Gjithashtu, një pjesëmarrës ishte i interesuar në lidhje me rolin e projektit për aktivitetet për të rinjtë në lidhje me zonat turistike dhe të mbrojtura se si do të zhvillohet. Por, në shkëmbimin e mendimeve bazuar në KMSM pjesëmarrësi tjetër ishte shumë transparent dhe shpjegues dhe në të njëjtën kohë duke treguar se (si) ata janë të njohur me përmbajtjen e KMSM-së.

Çështjet më të spikatura të shpjeguara ishin si më poshtë:

1. A është e nevojshme të bëhet Vlerësimi Strategjik mbi Ndikimin në Mjedis²⁹ për secilin projekt apo Komunë? R; projekti do të dorëzohet në formë të vogël dhe do të investohen vetëm në nënprojekte nën idenë e qartë pa ndikim në mjedis (duke përjashtuar projektet e kategorisë A) bazuar në kategorinë e projektit (kategoria B), pasi që natyra e projektit do të jetë në linjë me kornizën brenda KMSM-së.
2. A mund të financohen zonat e mbrojtura, p.sh. restaurim i vogël në vendet turistike?³⁰
R: Qëllimi i projektit është të përmirësojë përfshirjen socio-ekonomike të të paktën 3,000 të rinjve të pa-favorizuar (të moshave 14-29 vjeç) në komunitetet e cënueshme në Kosovë përmes aktiviteteve të angazhimit qytetar.

Përfundim:

Parashikuesit/përfaqësuesit nuk kishin asnjë kundërshtim ndaj KMSM-së dhe nuk ofruan ndonjë vërejtje vendimtare për përmbajtjen. Të gjithë pjesëmarrësit në takim shprehën qëndrimin e tyre pozitiv drejt zbatimit të projektit dhe e përshëndetën takimin si shumë të domosdoshëm për të qenë më të njohur me KMSM-në për zbatimin e nën-projektit brenda komunave në kuadër të këtij dokumenti.

Përveç kësaj, në periudhën përkatëse (deri më 14 dhjetor 2018) nuk janë pranuar asnjë koment apo kundërshtim tjetër mbi Kornizën e Menaxhimit Social të Mjedisit.

Prishtinë, 15 Dhjetor 2018

²⁹ Pas konsultimit të KMSM-së, pjesëmarrësit morën shpjegime shtesë me shkrim: Vlerësimi Pas-Strategjik mbi Ndikimin në Mjedis' nuk do të përgatitet për asnjë nga nën-projektet, vetëm Vlerësimi Mjedisor (kryesisht lista kontrolluese e KMSM-së, në dispozicion në KMSM) dhe vetëm për kategorinë B (disa ndikime në mjedis).

³⁰ Pas konsultimit të KMSM-së, pjesëmarrësit morën shpjegime shtesë me shkrim: Asnjë aktivitet në zonat e mbrojtura të natyrës nuk mund të ndodhë (pasi OP/BP 4.04 Habitatet Natyrore nuk shkaktohen për projektin).














Linku i publikimit:

The screenshot shows a web browser window with the URL <https://mapl.rks-gov.net/publikime/>. The page header includes navigation links: Komunitet, Portali Shtetëror, Gazeta Zyrtare, Konsultimet Publike, Qasja në Dokumento Publike, Arkiva e Ueb-faqes, and Prokurimi. A search bar is located on the right with the text "Kërko...".

The main content area features the logo of the Ministry of Local Government Administration and the following menu items:

- REPUBLIKA E KOSOVËS
- MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
- RRETH NESH
- ORGANIZIMI
- LAJME
- LEGJISLACIONI DHE POLITIKAT
- POLITIKAT DHE STRATEGJITË
- KONTAKTI DOKUMENTET E VJETRA
- SHPALLJE KONKURSE PUBLIKIME
- RAPORTET VJETORE TË MAPL-SË
- PLANET VJETORE TË PUNËS SË MAPL-SË

PUBLIKIME

 FLETË INFORMATIVE - JANAR-DHJETOR 2016 Data e publikimit: 13/04/2018	 Përmirësimi i Bashkëpunimit i IPA Programeve të Ba... Data e publikimit: 14/06/2018	 Raport - Konferenca Përfundimtare e Programit IPA ... Data e publikimit: 19/06/2018	 Për konsultim publik - UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MAP... Data e publikimit: 05/07/2018
 Dokument Konsultimi për Projekt - Udhëzimi Admini... Data e publikimit: 05/07/2018	 DRAFT UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR. 01/2018 PËR... Data e publikimit: 05/07/2018	 PROJEKT - UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) Nr. 03/2018... Data e publikimit: 23/08/2018	 BULETINI - PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT IPA Pr... Data e publikimit: 26/09/2018
 Raporti nga procesi i konsultimit publik për Udhëz... Data e publikimit: 15/11/2018	 Publikimi i Kornizës së Menaxhimit Mjedisor dhe So... Data e publikimit: 30/11/2018	 Korniza për Menaxhimin Mjedisor dhe Social për Pr... Data e publikimit: 30/11/2018	 Dokument konsultimi për Projekt-Udhëzimin Adminis... Data e publikimit: 10/12/2018
 UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MAPL) NR.05/2018 PËR MONIT... Data e publikimit: 10/12/2018			

Lista e pjesëmarrësve:

1.	Ylber Kastrati	Mamusha, Municipality
2.	Cafer Morina	Mamusha, Municipality
3.	Besarte Kryeziu Rama	Malisheva, Municipality
4.	Nderim Krusha	MLGA
5.	Afrim Berisha	Agency for Environment Protection
6.	Naim Alidema	Ministry of Environment and Spatial Planning
7.	Biondina Kleqka	Rahovec, Municipality
8.	Qemal Krasniqi	Rahovec, Municipality
9.	Tafil Peci	Mitrovica, Municipality
10.	Lumnije Azemi	MLGA



Lista e pjesëmarrësve

Konsultimi publik për Kornizen për Menxhimin Social Mjedisor, MAPL me dt 12.12.2018 koha: 11:00 -12:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri Ime I prezime	Institucioni Institucija	Pozita Pozicija	Nr Tel Br Tel	E-mail	Nënshkrimi Potpis
1.	YLBER KASTRATI	K. MAMUSHË	shqj Selator	005878697	ylber.kastrioti@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
2.	CABER MORIZA	K. MAMUSHË	DKA Mamushë	045-120312	cabermoriza@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
3.	BESARTE KEZEZIU-RAMAS	Komuna MALWATEVË	Drejtoreshë e DKRS-se	045/976/099	besarte.kezeziu@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
4.	NDERIM KRAJKA	MAPL-	PERLITHYES	044/219-493		<i>[Signature]</i>
5.	AFRIM BERISITA	MMPH/AMMK	ndihmë D.V. gjimn	044/374-888	afrim.berisita@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
6.	Naim Hoxha	MMPH/AMMK	zyrtar i lartë p.g. vurr/uzr	044/20073	naim.alidomaj@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
7.	Biondina Klegta	K. RAHOVEC	Drejtoreshë e DKRS-se	045/434-007	biondina.klegta@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
8.	Gemajl Krasniqi	RAHOVEC	SHREJTRIT I SPORT	044/115835	gemajl.krasniqi@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
9.	TALIR PEÇI	HITROVLICE	DEKANA DKRS	049/921795	talir.peci@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
10.	LUMNIJE AZEM	MAPL	U.D. DORRHEGES EDP	044/896049	Lumnje.azemi@rkj.gov.net	<i>[Signature]</i>
11.						

